



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor

“Art dhe Dizajn”

Universiteti POLIS

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Fisnik KADIU Dr. Prof. Asoc.

Gafurr MUKA Dr. Prof. Asoc.

Maj 2025

Tabela e përgjithshme për programin e studimit Bachelor në “Art dhe Dizajn”

1	IAL aplikues:	Universiteti POLIS
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti i "Arkitekturës dhe Dizajnit", Departamenti “Art dhe Dizajn”
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “ART dhe Dizajn”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 406, datë 26.05.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMAS Nr. 111, datë 16.05.2023
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 01, datë 01.02.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vjet/ 6 simestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite
11	Forma e studimit:	Kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6-të
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti 2024-2025 27 PAE/ 5 PAK Viti 2023-2024 27 PAE/ 6 PAK Viti 2022- 2023 22 PAE/ 6 PAK
18	Numuri i studentëve	Viti 2024-2025 81 studentë Viti 2023-2024 96 studentë Viti 2022- 2023 89 studentë
	Komente te tjera	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për programin e studimeve cikli i parë Bachelor në “Art dhe Dizajn” ofrohet nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti POLIS” në përputhje me standardet kombëtare e ndërkombëtare të arsimit të lartë, për të cilin janë angazhuar ekspertë të jashtëm, stafi akademik i universitetit, studentë dhe palë të intresuara.

Faza e përgatitore, përfshin një raport të vlerësimit të brendshëm i detajuar, në të cilin janë dhënë njohuri për programin e studimit, përfshirë kurrikulën, mësimdhënia, stafi dhe kualifikimet e sejcilit, rezultatet e mësimi dhe mundësitë e karrierës dhe infrastruktura.

Vizita e ekspertëve të jashtëm, i përbërë nga 2 (dy) akademikë me njohje në fushën e mësimdhënies në arkitekturë dhe dizajn, u krye në datat 27 dhe 28 Mars 2025. Kjo vizitë në institucion për vlerësimin e këtij programi studimi u bazua në shqyrtimin e raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe informacioneve shtesë të grumbulluara nga takimet dhe intervistat me stafin akademik, studentët, sekretarinë mësimore, inspektimin e infrastrukturës dhe palë të tjera të interesuara të institucionit për realizimin e tij.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm, u hartua nga grupi i ekspertëve të jashtëm, në të cilin janë të përfshira të gjitha gjetjet, rekomandimet dhe vlerësimi i tyre. Raporti trajton përputhshmërinë e kurrikulës me objektivat e programit, cilësinë e studentëve dhe mbështetjen për ta, metodat e mësimdhënies dhe efektivitetin e tyre, stafin dhe kualifikimet e tyre etj.

Plani i veprimit dhe përmirësimit, përfshin rekomandimet e raportit të vlerësimit të jashtëm, për të cilat institucioni duhet të hartojë planin e veprimit për të adresuar të gjitha çështjet e ngritura, me afate kohore dhe përgjegjësitë, që i shërbejnë përmirësimit të programit të studimit në “Art dhe Dizajn”. Monitorimi dhe Rishikimi, realizohet nga institucioni në bashkëveprim me organet e arsimit të lartë. Në këtë plan duhet të paraqiten afatet dhe përgjegjësitë për zbatimin e veprimeve përmirësuese.

Procesi i vlerësimit të jashtëm është i rëndësishëm, sepse ai siguron dhe garanton që, programi Bachelor në “Art dhe Dizajn”, që ofrohet nga Universiteti Polis, plotëson të gjitha kërkesat akademike dhe profesionale të fushës, sepse i shërben përgatitjes së studentëve në përputhje edhe me kërkesat që shtron tregu i punës.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për programin e studimit Bachelor “Art dhe Dizajn” që ofrohet nga Universiteti POLIS, synon të ofrojë një ekspertizë të qartë dhe transparente për funksionimin e programit dhe njësive kryesore që janë përgjegjëse për realizimin e tij. Në qendër të këtij procesi, ka qenë promovimi i sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë të programit të studimit në përputhje me kërkesat që shtron koha.

RVJ, është përgatitur nga Grupi i vlerësimit të Jashtëm (GVJ), i përbërë nga:

Fisnik Kadiu, Prof. Assoc. Dr

Gafurr Muka, Prof. Assoc. Dr.

Mbështetur në dokumentacionin e ofruar nga Universiteti POLIS, të sistemuara në portalin e ASCAL, gjatë periudhës Shkurt-Prill 2025. Koordinator Teknik i ASCAL. ka qenë Znj.Anilda Beqiraj.

Procesi është zhvilluar në këto faza kryesore:

1. Shqyrtimi i dokumentacionit dhe RVB të institucionit,
2. Vizita e organizuar në universitetin POLIS, takime me stafin akademik, studentët e programit të studimit në “Art dhe Dizajn” dhe aktorë të tjerë përgjegjës e kontribues për këtë program studimi etj.,
3. Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Jashtëm.

Përfundimet e arritura gjatë këtij procesi të vlerësimit, reflektojnë mendimet e antarëve të GVJ, të analizuar dhe argumentuar mbi bazën e standardeve dhe kritereve të përcaktuara.

GVJ nëpërmjet këtij Raporti ka paraqitur situatën aktuale të zhvillimit të këtij programi studimi në universitetin POLIS, duke besuar se informacioni i përgatitur do të ndihmojë bordin e akreditimit të marrë një vendim të drejtë dhe objektiv.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE
NGA AKREDITIMI I FUNDIT

Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.1, datë 01.02.2019 janë:

- I. Megjithëse është në objektivat dhe planet afatshkurtra të IAL-së, Institucioni inkurajohet të vazhdojë investimin për rritjen e kapaciteteve laboratorike, me qëllim përfitim nga ana e studentëve të kompetencave në përputhje me kërkesat aktuale në tregun e punës.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

GVJ e konsideron të zgjidhur këtë rekomandim të Bordit të Akreditimit.

Gjatë vizitave në mjediset e Universitetit POLIS, GVJ u njoh me masat e marra dhe investimet e kryera për rritjen edhe të kapaciteteve laboratorike ekzistuese dhe atyre të reja në shërbim të programit të studimit Bachelor në “Art dhe Dizajn”. GVJ, vlerëson punimet e realizuara nga studentët në Laboratorin e Qeramikës, Laboratorin e Prototipizimit, Laboratorin e Fotografisë, Laboratorin e CAD, Laboratorin e MAC dhe Laboratorin e Pikturës dhe Ilustrimit.


Universiteti Polis është njohur me DRVJ më datë 22.04.2025, përmes sistemit AMS, formë zyrtare me shkresë Nr 87/14 Prot date 22.04.2025.

Universiteti dërgon komente datë 25.04.2025. me shkresë Nr 386/25

GVJ dërgon memon si me poshtë:



Standardi	Konkluzione nga GVJ	Komente nga institucioni	Shenime nga GVJ
IV.1 Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kritereve të këtij standardi, GVJ vlerëson që tek Universiteti Polis personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush plotësisht standardet lidhur me angazhimin e personelit me tituj dhe grada shkencore. GVJ nisur nga ngarkesa disi e shbalancuar e PAE rekomandon balancimin e saj duke konsideruar edhe një ngarkesë në masën 300 deri 360 orë mësimore.	Universiteti POLIS mirëpret rekomandimin e GVJ-së për balancimin e ngarkesës së PAE, por duam të theksojmë se stafi akademik me një ngarkesë më të ulët orësh përfaqëson nivelin më të lartë akademik (profesor), të cilët janë njëkohësisht anëtarë të Këshillit të Profesorëve. Angazhimi i tyre në këtë strukturë përbën një pjesë të konsiderueshme të ngarkesës, duke ndikuar në mënyrë të natyrshme në balancën e orëve mësimore.	Referuar Tabelës 4 GVJ konstaton që ngarkesa e personelit me titull profesor në dy raste është më e vogël se 300 orë (përkatësisht 130 dhe 211 orë). Ngarkesa plotësuese për këto 2 profesorë vjen si informacion shtesë për GVJ. Sidoqoftë, nga tabela 4 rezulton që e gjithë ngarkesa e PAE është më e madhe se 360 orë (vetëm në një rast 331 orë). Në këto kushte vlersojmë të mbetet rekomandimi për ta ulur ngarkesën (kryesisht atë mbi 400 orë) në 300-360 orë, edhe për tu dhënë mundësi PAE me gradë Dr, KDr dhe Msc të kenë më shumë kohë në dispozicion për kualifikim të mëtejshëm. Duke mos qenë detyrim për institucionin konsiderimi i rekomadimit mbetet në dorë të tij.
IV.5 Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kritereve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Polis në stadin aktual garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e	Universiteti POLIS vlerëson sugjerimin e GVJ-së dhe dëshiron të nënvizojë se ka një qasje të qëndrueshme dhe afatgjatë ndaj financimit. Përveç buxhetit vjetor, institucioni harton parashikime financiare 3 dhe 5-vjeçare, të cilat përditësohen çdo vit. Kjo bën të mundur që universiteti të	GVJ referuar tabelës nr. 18 konstaton që zëri i të ardhurave nga "Tarifat për dhe gjatë studimit" për tre vitet akademike 2021-2022, 2022-2023 dhe 2023-2024 zë një peshë të përgjithshme prej 90.5%, kurse dy zërat e tjerë aktivë "Grantet për kërkim dhe kontratat" si dhe "Të ardhura të tjera" zënë përkatësisht 7.3 dhe 2.2 %. Gjykuar mbi këto të dhëna GVJ sugjeron diversifikimin e mëtejshëm të burimeve financiare në mënyrë që të



	studentëve. GVJ gjykon që në perspektivë, nëse zvogëlohet numri të studentëve, tarifat e studimit ose mund të bëhen të papërbalueshme ose jo interesante në raport me konkurrencën prandaj GVJ sugjeron diversifikimin e mëtejshëm të burimeve financiare në mënyrë që të ardhurat nga tarifat e studentëve të mbeten të përbalueshme prej tyre.	reagojë në kohë ndaj çdo ndryshimi në treg apo numrit të studentëve. Qëndrueshmëria financiare e Universitetit paralelisht bazohet edhe në diversifikimin e të ardhurave përmes projekteve HORIZON, Erasmus+, Creative Europe, Aleanca BAUHAUS4EU dhe projektet bilaterale.	ardhurat nga tarifat e studentëve të zënë peshë më të vogël në të ardhurat e institucionit. Nga komenti i U-Polis GVJ informohet që ky diversifikim realizohet nga të ardhurat përmes projekteve HORIZON, Erasmus+, Creative Europe, Aleanca BAUHAUS4EU dhe projektet bilaterale. Si informacion shtesë GVJ e pranon këtë koment
VI.1 kriteri 2	Për një vlerësim edhe më objektiv të aktivitetit të personelit akademik nga ana e studentëve, GVJ rekomandoi kategorizimin e dy grupeve studentësh bazuar në rezultatet e tyre: ata me rezultate të larta (psh me mesatare mbi 8) veç dhe të tjerët veç.	Institucioni vlerëson sugjerimin e GVJ-së për kategorizimin e studentëve bazuar në rezultatet e tyre gjatë vlerësimit të stafit akademik. Universiteti POLIS inkurajon politika gjithëpërfshirëse për të rritur cilësinë e vlerësimeve nga studentët, gjithmonë duke i dhënë rëndësi procesit bazuar në vlerësimin anonim për aktivitetin e personelit akademik dhe lëndëve të programit, me qëllim për të mos krijuar risqe të mundshme të diskriminimit dhe perceptime të pabarazisë brenda komunitetit studentor.	Lidhur me këtë kriter GVJ ka konfirmuar plotësimin e tij dhe ka sugjeruar një procedurë tjetër me grupim të studentëve në dy nëngrupe bazuar në mesataren e tyre, me arsyetimin se kjo procedurë do të rriste më tej objektivitetin e vlerësimit. Është në dorë të institucionit ta konsiderojë ose jo këtë sugjerim

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor

“Art dhe Dizajn”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimeve Bachelor ndërdisiplinor në “Art dhe Dizajn”, ofrohet nga Departamenti “Art dhe Dizajn” i Fakultetit të “Arkitekturës dhe Dizajn” (FAD) të Universitetit POLIS në përputhje dhe në harmoni të plotë me interesat dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Ky program synon të përmbushë nevojat e tregut vendas të punës, si dizajner në fusha aplikative të dizajnit në profile si, multimedia, grafikë, interior dhe dizajn produkti duke mundësuar përfshirjen e tyre në një kontekst shumëdisiplinor në sektorin privat ashtu dhe atë publik. Ai synon të zërë një rol të rëndësishëm në permiresimin e imazhit të bizneseve dhe markave, si një vlerë e shtuar në tregun vendas dhe atë të huaj. Programi i plotëson kriteret e këtij standardi dhe është në mbështetje të mbrojtjes së interesave kombëtare.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Bachelor në “Art dhe Dizajn” në Universitetin POLIS ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e Universitetit POLIS. Kërkesat në rritje të tregut për dizajner dhe mundësi integrimi shumëdisiplinor janë në përputhje edhe me objektivat formuese të këtij program studimi. Ai synon që specialistët e ardhshëm të jenë të përgatitur nga ana profesionale sipas kërkesave që shtron koha në fushat e dizajnit, të multimedias, grafikës, produkteve dhe interiorit në përgjithësi me interes në sektorin privat dhe atë publik. Referenca: <i>Aneksi 1, Statuti i Universitetit POLIS; Aneksi 6, Rregullore e programit të studimeve Bachelor “Art dhe Dizajn” viti 2024-2025.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.	Programi i studimeve në “Art dhe Dizajn”, është i organizuar sipas Ligjit Nr 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe në përputhje me misionin dhe qëllimin e Universitetit POLIS. Ky program përputhet me objektivat strategjike, misionin dhe vizionin e institucionit, duke respektuar strategjinë e zhvillimit dhe rregulloret e Tij. Sipas objektivave formuese programi i studimeve iu mundëson studentëve pajisjen me kompetencat e mjaftueshme në fusha të multimedias, grafike, interior, produkteve etj. Universiteti POLIS garanton lirinë akademike në mësimdhënie e mësimnxënie dhe aktivitete të ndryshme krijuese, duke synuar përgatitje me njohuri të thelluara dhe cilësi që i përgjigjet kërkesave për ciklin e parë të studimeve akademike. Referenca:

	<i>Aneksi 1, Statuti i Universitetit POLIS; Aneks 6, Rregullore e programit të studimeve Bachelor "Art dhe Dizajn" viti 2024-2025.</i>			
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Kapacitetet institucionale të institucionit janë në përputhje me kurrikulën e programit të studimit që ofrohet në këtë fushë. Personeli që aktivizohet për të dhënë leksione, seminare dhe praktika mësimore përbëhet nga staf akademik, të cilët vijnë nga fusha me përvojë të ndryshme ekspertize kryesisht në atë të arkitektures, por përfshin edhe ekspertë të artit dhe të dizajnit grafik dhe të interiorit, si rezultat edhe i ndërkombëtarizimit të programit në nivel shkëmbimi stafi dhe studentësh. <i>Referenca:</i> Aneksi 28.1,2,3,4: CV-të Personelit Akademik;			
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fusha e programit të studimit Bachelor në "Art dhe Dizajn" është në përputhje edhe me standardet e udhëzimeve evropiane për arsimin e lartë, të menaxhuar nga Fakulteti i Arkitektures dhe Dizajnit si njësi kryesore, e cila bashkërendon mësimdhënien e kërkimin shkencor dhe përputhet plotësisht me fushën akademike që ajo ofron. Ky Fakultet mbulon tre disiplina të rëndësishme të organizuara në njësi bazë si: Departamenti "Art dhe Dizajn", Departamenti i "Arkitekturës dhe Inxhinierisë" Qendra Kërkimore në Arkitekturë, Inxhinieri dhe Dizajn. Programi i studimit është bazuar në klasifikimin dhe kodifikimin e programeve sipas direktivave kombëtare dhe evropiane. Kohëzgjatja e programit është 3 (tre) vite akademike me 180 kredite ECTS. Referenca: Aneksi 1: Statuti i Universitetit POLIS.			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson se Programi i studimeve Bachelor në "Art dhe Dizajn", ofrohet nga Departamenti "Art dhe Dizajn" i Fakultetit të "Arkitekturës dhe Dizajnit" (FAD) të Universitetit POLIS në përputhje dhe në harmoni të plotë me interesat dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore si dhe interesat strategjike kombëtare. Programi synon që profesionistët e diplomuar të jenë të formuar sipas kërkesave që shtrihen koha në fushat e artit dhe dizajnit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Universiteti POLIS ka bashkëpunime si brenda institucionit me Fakultetin e “Arkitekturës dhe Dizajn” nëpërmjet përmbushjes së detyrave midis njërive e personelit për të siguruar mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit. Identifikimi i problematikave dhe adresimi i tyre për të përmirësuar cilësinë e programeve dhe duke siguruar, që ato të përputhen me standardet e nevojshme akademike dhe profesionale, krijimin e frymës së bashkëpunimit dhe punës në grupet e kërkimit. Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi edhe me organizma publike dhe private, madje edhe vete në kurrikulën e këtij programi është reflektuar ky bashkëpunim, të lidhura ngushtë dhe me fushën e dizajnit. GVJ, gjatë takime me stafin dhe studentët konstaton se universiteti POLIS nxit edhe bashkëveprimin midis antarëve të vetë stafit në nivel fakulteti dhe departamenti për të nxitur nisma të përbashkëta për projekte kërkimore, publikime në aktivitete shkencore, pa shmangur kujdesjen për një jetë të pasur dhe aktive sociale. Referenca: <i>Aneks 30, Tabela 5 - Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese në nivel programi; RVB, Raport Vlerësimit të brendshëm; GVJ, takime në institucion me stafin dhe studentët.</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve Universiteti POLIS është thelbësor për integrimin e formimit teorik me atë kërkimor shkencor dhe praktik të tyre. Institucioni ka vendosur marrëdhënie të mira bashkëpunimi edhe me organizma publike dhe private, gjë që është reflektuar edhe në kurrikulën e këtij programi studimi, duke lidhur marrëveshje bashkëpunimi me komunitetin e artit dhe dizajnit që operojnë në fushën e dizajnit të aplikuar e më gjerë në fushën e dizajnit. Në funksion të programit të studimit, universiteti POLIS ka zgjeruar rrjetin e bashkëpunimeve duke përfshirë universitete të tjera homologe në lidhje me programin e studimit Bachelor në "Art dhe Dizajn" siç janë: Universiteti i Shkencave të Aplikuara Anhalt / Bauhaus, Gjermani; Royal Academy of Art, Hage, Hollande; Academy of Fine Arts, Katania, Itali; Universiteti i Barit "Aldo Moro"; Laërence Technological University, Detroit, SHBA, Referenca: <i>Aneksi 30: Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese në nivel të programit të studimit "Art dhe Dizajn"; Tabela 5, Bashkëpunimi dhe organizatat bashkëpunuese në nivel programi.</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit,	Universiteti POLIS, bashkëpunon ngushtë me institucionet arsimore të njohura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke u zgjeruar në përputhje

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al



institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	me strategjinë e zhvillimit të Tij. Ato janë nga partnerë strategjikë, me të cilat universiteti POLIS ofron programe studimi të përbashkëta dhe partnerë ad hoc, me të cilat zhvillon ëorkshop-e të përbashkëta, veporimtari kërkimore shkencore dhe të tjerë, më të cilat kryen shkëmbime të studentëve e pedagogëve. GVJ, vlerëson bashkëpunime me “Agjensinë e Industrive Kreative”; “Landmark Communications”; “Kube Studios”; Bashkia Tirane; Bashkia Durrës; Bashkia Gjirokastrë; Universiteti i Arteve; Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi; DooArt; ParkStudio; Galeria Zeta, Aleanca BAUHAUS4EU; GIZ - Albania; COD - Center for Dialogue and Oppenes; Harabel Contemporary Art Center; Destil Creative HUB; Co-Plan; Metropolis; Microfolie Tiranë etj. në kuadër të praktikave mësimore, por edhe si raste zhvillimi produkti konkret për tregun vendas, mundësi internshipi dhe punësimi, vizita në kompani dhe pjesëmarrje në Panairin e Karrierës. Referenca: Aneksi 30, Tabela 5, Bashkëpunimi dhe organizatat bashkëpunuese në nivel programi.			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Zyra e Karrierës në bashkëpunim me njësine bazë harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të këtij programi studimi Bachelor në “Art dhe Dizajn”. Bashkëpunimi gjithashtu shihet dhe në nivel operacional në lidhje dhe me aktivitetet mbështetëse artistike; kërkimore inovatore në fushën e dizajnit si “ Javët e Arkitekturës në Tiranë dhe “Javët e Dizajnit në Tiranë”, ku entitete, organizata, kompani thirren për të ofruar kontributin e tyre në aktivitetet të cilat realizon nga departamenti i Art dhe Dizajnit; si p.sh TAË dhe TDË; Forumet e Artit dhe Dizajnit, workshope kombëtare dhe ndërkombëtare. Në mënyrë periodike, çdo vit akademik hartohet një dokument nga njësia bazë ku listohen të gjitha aktivitetet, të cilat lidhen me programin e studimit. Referenca: Aneksi 43, Formulari për kryerjen e praktikës- Internshipi			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson bashkëpunimin e departamentit me Fakultetin e “Arkitekturës dhe Dizajn” në përmbushje të detyrave për të siguruar mbikqyrjen dhe mbarëvajtjen e këtij programi studimi. Në funksion të programit të studimit, universiteti POLIS ka zgjeruar rrjetin e bashkëpunimeve duke përfshirë universitete të tjera homologe për programin “Art dhe Dizajn”. Në mënyrë periodike, çdo vit akademik hartohet dokumenti i njësive për të gjitha aktivitetet, të cilat lidhen me programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në “Art dhe Dizajn”, sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar) dhe sistemin e Bolonjës, përmban të gjitha elementët përbërës të strukturës për këtë program studimi: 1. Kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të krediteve, ECTS; 2. Kontrollin e dijeve dhe instrumentët e vlerësimit; 3. Objektivat formues dhe kompetencat profesionale; 4. Veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit; 5. Kategoritë e veprimtarive formuese; 6. Planin mësimor; 7. Kuotat e pranimeve; 8. Programin lëndor apo Syllabu-set; 9. Diplomën dhe Suplementin e diplomës. Programi i studimit në “Art dhe Dizajn”, është program i ciklit të parë, me kohë të plotë dhe kohëzgjatje 3 vite akademike me 180 kredite (ECTS); 1 kredit përmban 25 orë pune studenti, orë mësimor si leksione, seminare, ushtrime, laboratore dhe orë pune individuale për përgatitje. Programi përmban 21 lëndë të organizuara në 35 module, përfshirë internshipin profesional dhe Tezën dhe Projektin e diplomës; që lehtësojnë transferimin dhe lëvizshmërinë e studentit. Referenca: <i>Aneksi 4, Rregullore didaktike; Aneksi 6, Rregullore e programit Bachelor “Art dhe Dizajn” 2024-2025; Aneksi 18, Modeli i Diplomës dhe Suplementi i Diplomës; Aneksi 30, Tabela 14, Model Syllabusi; Aneksi 33, Politika e e marketingut-Polis, Kriteret e pranimi; Aneksi 40, Plan mësimor i programit “Art dhe Dizajn”.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të	Objektivat e programit të studimit janë të përcaktuara qartë për këtë program studimi, ku janë të përfshira të kuptuarit kritik të parimeve teorike akademike, zhvillim të njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale që, studenti do të përfitojë në përfundim të studimeve. Programi i studimit është i ndarë në 3(tre) pjesë të veçanta si vijon: 1. Thellim i formimit të përgjithshëm (Histori e Dizajnit, Fenomenologjia e Objektivit me Historia e Estetikës;

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. “Q. Stafa”, Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al



kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	2. Formim për kulturën artistike bazë dhe nga fusha të tjera (Baza e edukimit artistik, Gjuha pamore, Piktura, Gjeometria deskriptive, Vizatim dhe Ilustrim Grafik dhe Qeramika e Modelimi); 3. Formim në gjini të veçanta të artit të dizajnit (Fotografia, Teknologjia e Materialeve, Projektim Artistik, CAD dhe Artete Bazuara tek Kompjuteri, Dizajn Multimedial, Muzeografia dhe Expo, Dizajn Grafik). Referenca: Aneksi 06, Rregullore Bachelor në "Art dhe Dizajn"; Aneksi 12, Strategjia e zhvillimit të Programit.
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi i studimit përmban veprimtaritë formuese të grupuara në disiplina si vijon: (A)-Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë) 36 kredite ECTS/20%; (B)-Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues 96 kredite ECTS/53.5%; (C)Veprimtari në disiplina të formimit ndërdisiplinor, profile integruese 24 kredite ECTS/13.3%; (D) Veprimtari të formimit plotësues me disiplina karakterizuese 18 kredite ECTS/10%; (E)Veprimtari përmbyllëse, Teza dhe Projekt Diploma 6 kredite ECTS/3.3%. Në total 180 ECTS/100%, përcaktuar në zbatim VKM nr. 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar) dhe sistemin e Bolonjës.
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i Studimit Bachelor në "Art dhe Dizajn", ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse të programit. Intershipi Profesional është vlerësuar me 3 kredite ndërsa detyrimet përmbyllëse me Tezën dhe Projekt Diplomën janë vlerësuar me 6 kredite (ECTS)/3.3%, të cilat përfshihen përmes punës në lëndën studio "Teza dhe Projekt Diploma" që zhvillohen gjatë semestrit të dytë në vitin e tretë akademik të programit të studimit. Kualifikimi i studentëve dhe rregullat në procesin e diplomës janë përcaktuar në Rregulloren e Diplomës për Programin e Studimit Bachelor në "Art dhe Dizajn". Referenca: Aneksi 7, Rregullore e Diplomimit; Aneks 30, Tabelat përmbledhëse për aneks RVB.
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të	Organizimi i këtij programi studimi, përfshirë pranimin dhe financimin e studentëve realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 (i ndryshuar). Kandidatët, që fitojnë statusin e studentit kanë të drejtë të ndjekin studimet në vitin akademik në të cilin janë regjistruar. Dokumentacioni për regjistrim është në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, i paraparë në nenin 16 të Rregullores Didaktike të institucionit në fillim të çdo viti akademik.

lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Me ndryshimet në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Udhëzimeve të herëpashërëshme; nga viti 2016 lidhur me kriteret e pranimeve të studentëve të rinj ka pësuar ndryshime mesatarja e pranimeve, të cilat janë reflektuar edhe nga fakulteti i "Arkitekturës dhe Dizajnit", përgjegjës kryesor për këtë program studimi. Financimi i studentëve në Universitetin POLIS është në përputhje me koston e shpenzimeve; e cila llogaritet apo përditësohet në çdo vit akademik duke patur parasysh investimet për përmirësimin e infrastrukturës në shërbim të përmirësimit të cilësisë së procesit mësimor. Referenca: <i>Aneksi 33, Politika e marketingut, kërkesat për rregjistrim; Aneksi 4, Rregullore didaktike; Aneksi ... Financimi i studentëve</i>
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Me përfundimin e studimeve të ciklit të parë, studenti pajiset me Diplomë Bachelor në "Art dhe Dizajn" sipas sistemit të Bolonjës. GV, gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit përkatës konfirmon se programi i studimeve në ciklin e parë Bachelor në "Art dhe Dizajn" në Universitetin POLIS, është i ngjashëm si në emërtesë ashtu dhe në përmbajtje me programet, që ofrohen në vendin tonë, në nivel së paku me 70 për qind. Me përfundimin e studimeve të ciklit të parë, studentëve të pajisur me Diplomën përkatëse iu ofrohet mundësia për të vazhduar studimet në ciklin e dytë, në programin e studimeve "Dizajn i Aplikuar", që menaxhohet nga departamenti "Art dhe Dizajn" ose mund të punësohen në tregun e punës. Referenca: <i>Aneks 30 Tabelat përmbledhëse për RVB, Bachelor "Art dhe Dizajn".</i>
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimeve Bachelor në "Art dhe Dizajn" shoqërohet me kodin përkatës 63BA0210S, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve, i bërë publik nga Ministria e Arsimit e Shkencës me shkresë Nr.7381/14 Prot., datë 30.12.2024. GVJ, vlerëson se me këtë kod është bërë edhe kodifikimi i lëndëve të këtij program studimi, duke përmbushur kështu edhe kërkesat për këtë kriter. Referenca: <i>Aneksi 50. Shkresa zyrtare e MAS për kodifikimin e programit të studimit Bachelor në "Art dhe Dizajn"</i>
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky kriter i standardit nuk aplikohet për këtë program studimi.
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson se programi i studimit përmban të gjitha elementët përbërës të strukturës; kreditet, sipas Sistemit Evropian në</i>

	ECTS; kontrollin e dijeve dhe instrumentët e vlerësimit, objektivat formuese dhe kompetencat profesionale; veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë ;kategoritë e veprimtarive formuese; planin mësimorë;kuotat e pranimeve; programin lëndor dhe diplomën . Financimi i studentëve është në përputhje me koston e shpenzimeve; e cila llogaritet apo përditësohet në çdo vit akademik. Sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve programi i studimit është i shoqëruar me kodin përkatës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia bazë përgjegjëse kryesore për këtë program studimi Bachelor në “Art dhe Dizajn” është Fakulteti i “Arkitekturës dhe Dizajnit”(FAD) me 59 staf akademik; PAE 47 dhe PAK 12 i cili bashkërendon mësimdhënien me kërkimin shkencorë e zhvillimin kulturor; ndërsa realizimi i tij kryhet nga njësia bazë Departamenti “Art dhe Dizajn” GVJ, vëren se janë përmbushur detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi sa i përket organizimit dhe strukturës akademike, si dhe kërkesave për stafet akademike, numrin e titujve dhe gradave. Departamenti i “Art dhe Dizajn” ka në përbërje të tij një total prej 22 personel të punësuar, nga këto me kohë të plotë 16 antarë PAE, prej tyre Prof. Dr; 2 Prof. Asoc,1 .Dr. 4 Msc 9 6 PAK si personel akademik i ftuar, prej të cilëve Dr, 3. Msc 3 Departamenti mbështetet edhe nga personeli ndihmës akademik i IAL-së, i cili ndihmon për zhvillimin e mëtejshëm të aktiviteteve të ndryshme akademike. Nga vizita e GVJ në institucion, takimi me zyrën e burimeve njerëzore si dhe kontrollin e dokumentacionit të dërguar nga universiteti POLIS, vlerëson se departamenti i përmbush detyrimet për organiuzimin, strukturën dhe stafin akademik. ligjore. Referenca: Aneksi 01, Statuti i Universitetit Polis, neni 19- të dhe neni 22-të; Aneksi:30, Tabelat përmbledhëse;

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Bazuar në rregulloren e Programit të studimit, Njësia bazë përgjegjëse ka angazhuar personel akademik efektiv për ndjekjen e monitorimin e praktikave mësimore të studentëve përgjatë gjithë periudhës së praktikës e deri në përfundim të studimeve. Gjatë vizitës në institucion dhe takimi me studentët ata konfirmuan se janë të informuar nga Departamenti dhe ndihmohen nga personeli akademik i caktuar për realizimin e praktikave mësimore. Referenca: <i>Aneksi 31, Vendim për koordinatorët e programeve të studimit.</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Me vendim të Rektorit të Universitetit POLIS është miratuar koordinatori ,i cili është pjesë e stafit akademik me kohë të plotë në pozicionin e koordinatorit të programit të studimit “Art dhe Dizajn”.si përgjegjëse kryesore për ecurinë dhe organizimin e praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Referenca: <i>Aneksi 31, Vendim për koordinatorët e programeve të studimit.</i>			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson se njësia përgjegjëse për programin e studimit “Art dhe Dizajn”përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin, strukturën dhe stafet akademike. Programi i studimeve me vendim të rektorit ka përcaktuar koordinatorin e programit i cili është edhe përgjegjës për zhvillimin e programit dhe të praktikave profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Fakulteti i Arkitektures dhe Dizajnit (FAD) i drejtuar nga Dekani si njësia përgjegjëse kryesore dhe “Departamenti “Art dhe Dizajn” si njësi bazë përgjegjëse i programit të studimit Bachelor në “Art dhe Dizajn” kanë vënë në dispozicion të gjithë informacionin e nevojshme për organizimin, strukturën objektivat dhe përmbajtjen e programit. Përvoja 18-vjeçare e Universitetit POLIS, kualifikimi i stafit dhe vetë historiku i këtij programi garantojnë ecurinë normale të kërrij programi studimi. Referenca:

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	<i>Aneksi 2. Strategjia e zhvillimit e Uninversitetit POLIS; Aneksi 12 "Strategjia e zhvillimit të Programit"; Aneksi 28.1/28.2/28.3. CV kualifikimi i stafit.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Plani mësimor i programit Bachelor në "Art dhe Dizajn" realizohet në gjuhën shqipe, me kohë të plotë në 3 (tre) vite akademike (1 vit përmban 30 javë mësimore) ose 6 semestra (1 semestër ka 15 javë mësimore në auditor) dhe me 180 kredite (ECTS). GVJ, vlerëson se Programi i studimit është i plotë; Ai përmban 21 lëndë të organizuara në 35 module, ku janë të përfshira dhe një internship profesional (praktika) dhe teza e diplomës. Në përfundim të programit të ciklit të parë studenti pajiset me diplomë "Bachelor në Art dhe Dizajn". Ngarkesa mësimore është e organizuar në kredite ECTS, në përputhje me dispozitat ligjore të fuqi (1 ECTS përmban 25 orë mësimore pune të studentit) dhe në përfundim të tre viteve studentët marrin 180 ECTS. Plani mësimorë është vjetor, ndërsa kurrikulat janë objekt i rishqyrtimit periodik dhe miratimi i tyre kalon nëpërmjet Senatit Akademik. GVJ vlerëson të plota detajet për Programet e mësimore; ato përmbajnë lëndën, modulin, pedagogun/asistentët, ngakesat në orë totale, ndarjen javore të lëndëve në orë dhe kredite dhe mënyrën e vlerësimit. Kështu, Leksionet 8-12 orë në auditor dhe 13-17 orë pune e pavarur studentit. Seminaret 8-12 orë në auditor dhe 13-17 orë pune e pavarur e studentit. Laboratorët/Studio përmbajnë 10-12 orë në auditor dhe 13-15 orë pune e pavarur studentit. Për shkak të specifikave që ka ky program studimi, Praktikrat e lëndëve janë të përfshira në orët Laboratore dhe ato mësimore Studio, ndërsa praktika Profesionale përmban 5 orë në auditor dhe 20 orë pune e pavarur e studentit. Teza dhe projekti i Diplomës përmbajnë 12 orë në auditor dhe 13 orë pune e pavarur e studentit si dhe Studio/Ushtime/Workshope 12 orë në auditor dhe 13 orë pune individuale studentit) ndërsa në semetrin e dytë (Leksione 8 orë në auditor dhe 17 orë punë e pavarur e studentit si dhe Studio/Ushtime/Workshope 12 orë në auditor dhe 13 orë pune individuale e studentit).
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Informacionet e nevojshme për të gjitha procedurat e pranimit të studentëve në universitetin POLIS, përmbajnë dispozitat e përgjithshme, aplikimin, kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve janë të paraqitura në 'Rregulloren e Programit të studimeve dhe Politika e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Nje informacion i përgjithshem publikohet edhe në ëeb site të universitetit. Referenca: <i>Aneksi 4, Rregullore Didaktike.</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e	Një informacion i detajuar për programet e studimit përfshirë Rregulloret e programit të studimit Bachelor në "Art dhe Dizajn" si dhe

nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Plani mësimor respektiv gjenden pranë Departamentit “Arkitekturë dhe Dizajn” në të cilat janë të përfshira dhe përmbajtja e kurrikulës me të dhënat e ngarkesës mësimore për secilën lëndë në formë fizike dhe elektronike. Këto detaje dhe specifikime gjithashtu janë të përshkruara në përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve, në përputhje me VKM Nr.41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar). E njëjta formë është e reflektuar edhe në platformën e vlerësimit të sistemit të brendshëm PITAGORA. Referenca: <i>Aneksi 27, Syllabuset e programit; Aneksi 30, tabela përmbledhëse 14, Format Syllabusi.</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Gjatë vizitës në institucion dhe diskutimeve me stafin akademik, GVJ konstatoi se syllabus-et përditësohen dhe miratohen nga Senati Akademik përpara fillimit të çdo viti akademik. Nëpërmjet këtij procesi sigurohet që informacioni i ofruar studentëve është i saktë, aktual dhe i përditësuar. Përditësimi i syllabus-ve është një çështje thelbësore, e cila jo vetëm siguron përmirësimin e vazhdueshëm të programit, por gjithashtu mundëson dhe zbatimin e ndryshimeve të nevojshme për të reflektuar zhvillimet me të fundit në fushën e “Art dhe Dizajnit”. Kjo qasje e sistematike garanton që programi të ruaj freskinë në përputhje me nevojat dhe kërkesat e industrisë tregut, duke i përgatitur studentët me sfidat e tregut të punës.			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson se FAD si njësi kryesore përgjegjëse për programet e studimit disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. Programi i studimit përmban planin mësimor për drejtimin “Art dhe Dizajn” si dhe kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, syllabuset, përfshirë komponentët formues dhe përmbajtjen e programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe	GVJ, vlerëson se Programi i Studimit Bachelor në “ART dhe Dizajn”, sa i takon emërtimit, përmbajtjes, objektivave, shpërndarjes së lëndëve dhe praktikave është në përputhje me aktet ligjore dhe dhe nënligjore në fuqi dhe me nivelin e kualifikimit, përcaktuar nga korniza Shqiptare dhe ajo Evropiane e Kualifikimit. Ky program ka fokus të veçantë

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. “Q. Stafa”, Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	thelimin e njohurive dhe aftësive të studentëve në tematika profesionale, që kanë të bëjë me “Arti dhe Dizajn”, në përputhje me kërkesat e programit mësimorë të ciklit të parë Bachelor.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të nxënit.	GVJ, vlerëson se Lëndët/modulet në Programin e studimit Bachelor në “Art dhe Dizajn”, janë të shpërndara në vite dhe semestra. Kurrikula e programit, ngarkesa, lëndët dhe raporti teori/praktikë janë të vlerësuara në kredite dhe orë mësimore në raport me peshën dhe rëndësinë e secilës lëndë. Për të rritur rezultatet e pritshme të nxënit janë konsultuar praktikantët më të mira në universitetet partnere dhe eksperiencat e shkollave të ngjashme evropiane. I gjithë ky proces ndodh në mënyrë periodike sa herë lind nevoja për të reflektuar arritjet në këtë fushë të kërkimit shkencor. Referenca: <i>Aneksi 4, Rregullore didaktike e programit të studimit.</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	GVJ, vlerëson se struktura e programit, organizimi dhe e elementëve mësimorë të lëndëve, përfshirë dhe raportin teori/praktikë janë në përputhje me profilin e programit të studimit Bachelor në “Art dhe Dizajn”. Veprimtaria formuese teori/praktikë e deritanishme për GVJ ka treguar, që ky program është stimulues për formimin profesional të studentëve, sepse kriteret e vendosura janë përcaktuar qartë për një formim praktik të studentit dhe objektivave formuese të programit. Referenca: <i>Aneksi 4, Rregullore didaktike e programit të studimit.</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Për GVJ, Programi aktual i studimit Bachelor në “Art dhe Dizajn” ka treguar se pas disa viteve të zbatimit të tij, ka arritur të përcjellë tek studentët sigurinë për formimin e tyre profesional duke iu mundësuar atyre një transferim të sigurtë të studimeve sa herë është kërkuar. Efektive vlerësohen edhe mobilitetet në vende të ndryshme si dhe punësimin e tyre me përfundimin e studimeve. Në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë raportet midis formimit teorik dhe praktik të studentëve dhe objektivat formuese të programit. Pra, organizimi i kurrikulës sipas veprimtarive formuese në % të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe raporti i orëve teorike, seminareve dhe orëve praktike/laboratorit sigurojnë një përgatitje të mirë teorike dhe punësim të studentit me përfundimin e studimeve. Referenca: <i>Aneksi 4, Rregullore didaktike e programit të studimit; Aneksi 27, Syllabuset e programit.</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë	GVJ, vlerëson pozitiv Rishikimin e syllabuseve dhe përditësimin e tyre në mënyrë të vazhdueshme me të rejat më të fundit të teksteve akademike bazë ose ndihmëse në fushën e dizajnit. Institucioni studion tregun duke nëpërmjet pyetsorëve, konsulta me ekspertë të dizajnit për të marrë mendime dhe sidomos nga studentë të diplomuar. Syllabusi reflekton gjithashtu përmirësimin edhe me fushën kërkimore aplikative

literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	të saj që kërkon kjo disiplinë. Nga bisedat gjatë vizitës në institucion me studentët e programit të studimit. Referenca: <i>Aneksi 27, Syllabuset e programit.</i>			
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	GVJ, vlerëson hartimin dhe ofrimin e programeve të studimit dhe pershtatjes se tyre me nevojat e tregut të punës. Ky studim tregu kryhe duke përdornr metoda formale (pyetësore) e informale (konsulta me ekspertë), ku merret mendimi i një game të gjerë aktorësh kryesisht nga komunileti i fushës së dizajnit por dhe te tjerë si ekspertë të fushëës e të arsimit të larte dhe sidomos i studentëve të diplomuar nëpërmjet shoqatës së ALUMNI. Referenca: <i>Aneksi 11, Studimi i tregut të punës; Aneksi 20, Pyetsor ALUMNI.</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	GVJ, vlerëson Programin Bachelor në “Art dhe Dizajn” në Universitetin POLIS për mundësitë që ofron në punësimin e studentëve të saj me përfundimin e studimeve. Gjatë takimit me studentët, GVJ, u njoh edhe me përmbajtjen, që programi u mundëson atyre që me përgatitjen teorike të mund të vazhdojnë studimet e tyre jo vetëm në nivelin e Masterit në fusha të tjera të ngjashme të dizajnit në përshtatje të me shpejtë dhe kërkesat në tregun e punës.			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson emërtimin, përmbajtjen e veprimtarive dhe praktikave; lëndët dhe fvshpërndarje e tyre në vite e semestra, vlerësimin në kredite e orë mësimore. Struktura e programit është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Veprimtaria formuese teori/praktikë e deritanishme për GVJ ka treguar, që ky program është stimulues për formimin profesional të studentëve dhe punësimin e tyre në përshtatje me kërkesat e tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe	Programi i studimit Bachelor në “Art dhe Dizajn” ofron njohuri të mira në bazuar në metoda dhe parime shkencore të përgjithshme në fushën e Artit dhe Dizajnit. GVJ vlerëson se programi i studimit siguron një bazë premtuese të njohurive për artin dhe dizajnin gjatë studimeve 3-vjeçare dhe përshtatjen me kërkesat e tregut të punës. Studentët

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	formojnë kompetenca në disa disiplina teknike dhe specifike në fushën e dizajnit, duke përfshirë artet, grafikën, multimedien, teorinë e praktikën e dizajnit etj. GVJ, vlerëson bashkëpunimi e vazhdueshem me aktorët e tregut të punës, institucionet partnere të ngjashme; studentë të diplomuar dhe të punësuar në studio të dizajnit dhe organizata të ndryshme, duke i shërbyer zhvillimit të karrierës të studentëve në funksion të kërkesave të tregut të punës. Referenca: <i>Aneksi 12, Strategjia e Zhvillimit të Programit.</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Universiteti POLIS, në traditën e tij ka krijuar një mjedis ku marrëdhënia ndërmjet institucionit, stafit akademik dhe studentëve është thelbësore. GVJ, vlerëson përfshirjen e studentëve në proceset vendimmarrëse të Senatit dhe të Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë në universitet, si dhe pjesëmarrja e tyre në vlerësimin e lëndëve/kurrikulës së programit dhe mësimdhënies. Po kështu, GVJ, vlerëson dhe përkushtimin e institucionit për të dëgjuar dhe për të vlerësuar kontributin e studentëve në strukturat e tyre për përmirësimin e programit të studimeve. Nga ana tjetër, Qeveria Studentore dhe lidhjet e vazhdueshme me të diplomuarit, të koordinuara nga Zyrja e Karrierës dhe Alumni, sigurojnë një rrjet bashkëpunimi që ndihmojnë në përmirësimin e programit të studimit. GVJ, i vlerëson këto kontakte për të përfutur nga përvoja dhe sugjerimet e të diplomuarve të punësuar në tregun e punës në fushën e dizajnit në tërësi dhe atë të dizajnit aplikativ në veçanti. Përfaqësia e studentëve paraqitet në linkun https://universitetipolis.edu.al/ep-content/uploads/2024/12/3.PërfaqësiaStudentore-2024-2025.pdf; https://universitetipolis.edu.al/senati-studentor-2/ Referenca: <i>Aneksi 01, Statuti i Universitetit POLIS; Përfshirja e studentëve në Senat, NjSBC, Këshilli i Etikës; Aneksi 20, Pyetsori Alumni,</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Departamenti i "Art dhe Dizajn" në universitetin POLIS, ka krijuar dhe forcuar bashkëpunime me studio lokale dhe entitete shtetërore e private të ndryshme në tregun e punës, të cilat ndihmojnë dhe kontribuojnë për përmirësimet dhe përditësimet e programit të studimit. Prania në universitet e Innovation Factory; Inkubatorit dhe Akseleratorit "Tirana Inc", Studios se Arkitektures, Dizajnit dhe Inxhinierisë, Institutit "MetroPOLIS", Co-PLAN, Qendra MAD-Center, pasuron përvojat kërkimore, inovatore si dhe praktike të stafit dhe studentëve me tregun e punës; jo vetëm lokal por dhe atë Europian. GVJ vlerëson bashkëpunimet me Bashkia e Tiranës, Bashkia e Durrësit, Bashkia e Gjirokastrës, Bashkia e Shkodrës, Muzeu Marubi, Muzeu Gjon Mili, IVAF (International Video Art Festival), Art House Shkodër, Zeta Qendër për Artin Bashkohor, AVAN (Tirana Art Week), Instituti i

	Kulturës Italiane Tiranë, UNA (United Nations Albania), COD - Center for Openness and Dialogue, etj Referenca: <i>Aneksi 42. Institucionet dhe organizatat bashkepunuese .2024.</i>			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson bashkëpunimin e vazhdueshëm me aktorët e tregut të punës, institucionet partnere të ngjashme; studentë të diplomuar dhe të punësuar në studio të dizajnit dhe organizata të ndryshme. që i shërbejnë zhvillimit të karrierës të studentëve në fuksion të kërkesave të tregut të punës. Njësia përgjegjëse, FAD përmirëson dhe përditëson sistematikisht programin e studimit Bachelor në "Art dhe Dizajn" me propozimet dhe zhvillimet më të fundit në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata dhe institucione private e publike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive që aplikohen e perdoren për programet në ciklin e parë Bachelor janë janë të ndryshme; ato synojnë pjesëmarrjen aktive dhe kontributin e përbashkët pedagog-student. GVJ nga format e veçanta të mësimdhënies për këtë program studimi veçon format: <i>Punën në grup</i> , e cila bazohet në fushën e artit dhe të dizajnit " <i>Punën në Atelië/Studio</i> ", për hartimin e projekteve në grupe mësimore, në syllabuset e lëndëve, në vizita në <i>Atelië/Studiostudio</i> , vizita në <i>ekspozita, panairë, projekte</i> etj., të cilat realizohen në përputhje me planin mësimorë. <i>MAD Center e Universitetit POLIS</i> , i kushtohet pjesëmarrjes së studentëve në ekspozita të projekteve artistike, dizajnuese dhe arkitekturore. Që nga viti 2011 MAD Center ofron një hapësirë aktive për aktivizimin e studentëve të Universitetit POLIS, https://mad-center.org/about/ . Një tjetër metodë në kuadrin e mësimdhënies është edhe <i>Artist and Designer Talk</i> në <i>Forumet e</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	Hapura, që organizohet me leksione, prezantime, kërkime, projekte nga ekspertë të ftuar vënda dhe të huaj. https://mad-center.org/past-forumet-e-aitit/. Tirana Design Week, organizohet çdo vit nga Universiteti POLIS, në të cilin Staf i Fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajnit krijojnë çdo vit tematika dhe hapësira për ëorkshope të ndryshme si forma të mësimdhënies me lektor të jashtëm ndërkombëtarë. https://forumap.org/ dhe https://tiranaarchitecturewww.com. Gjithashtu, studentë të programit Art dhe Dizajn angazhohen dhe në aktivitete, projekte dhe studime të Co-Plan apo Metropolis, duke krijuar fushata promovimi dhe imazhi për kompani të ndryshme në fushata sensibilizuese dhe ndërgjegjëse. Referenca: Aneksi 30, tabelat përmbledhëse, Programi lëndor; Aneksi 30, Tabelat, Plani mësimor në Dizajn i Aplikuar.
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	GVJ, vlerëson Stafin e Departamentit të "Art dhe Dizajn" për t'ju përgjigjur nevojave dhe kërkesave të studentëve, duke ofruar leksione dhe aktivitete të ndryshme akademike siç janë leksionet e hapura, praktika në atelie, vizita në studio dizajni, ëorkshope, ekspozita studentore, etj. si mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. shoqerise se sotme. Referenca: Aneksi 04, Rregullore didaktike-Aktivitete Studio etj..
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.	GVJ, vlerëson mbështetjen që institucioni i jep personelit akademik të tij për përmirësimin e kompetencave didaktike, duke i dhënë rëndësi sidomos personelit të ri, duke i orientuar ata për çështje të administrimit të procesit mësimorë në klasë dhe jashtë saj, metodave që përdoren në varësi të lëndëve, etikës, komunikimit dhe frymës së përgjithëshme që institucioni nxit tek stafi i tij. Universiteti POLIS informon stafin e tij akademik për të marrë pjesë në programe mobiliteti (ERASMUS+) me institucionet partnere të huaja për të shkëmbyer përvoja në mësimdhënie dhe kërkime shkencore. Po ashtu, zyrtarë të ndryshëm të Universitetit POLIS informojnë rregullisht stafin për mundësitë e pjesëmarrjes në trajnime, seminare, konferenca, në fushat e metodologjisë të mësimdhënies, udhëheqjes së punës kërkimore të studentëve, në menaxhimin e proceseve akademike organizuara jashtë institucionit. Universiteti POLIS aplikon edhe mënyra të tjera për mbështetjen e stafit akademik, si p.sh. nëpërmjet "Programi ndërkombëtar i Doktoraturës në Arkitekturë dhe Planifikim Urban- IDAUP", i cili organizohet në bashkëpunim me Universitetin e Ferrarës në Itali. Një tjetër mënyrë është edhe qëndrimi për periudha kohore të shkurtra për trajnime lidhur me eksperiencat didaktike në institucione partnere ndërkombëtare për udhëheqjen e punës kërkimore të studentëve ku dallojnë :SPORES - "intermedial

	experiences" at the crossroads of arts and technology; Culture Couture - Merging Fashion and Tradition for Sustainable Style; DRIVE - Developing Research and Innovation Capacities in Albania and Kosovo; VTECI-1 - Accelerating Eastern Balkans University Modernization by Incorporating Virtual Technologies; IDEA - Inclusive Tertiary Education in West Balkans; STEFORA- STEM for All dhe ROAMING - Strengthening International Staff & Student Mobility Offices in the Eastern Balkans.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Përgatitja e stafit akademik efektiv dhe me kontratë janë kërkesa adekuate edhe për këtë programin e studimit "Bachelor" në "Art dhe Dizajn" me lëndët mësimore të cilat janë pjesë e kurrikulës, stafi akademik i rregullt dhe ai ndihmës iu ofrojnë studentëve mundësi të mëdha për shpjegime për rastet studimore të dala edhe nga praktikat e realizuara në institucione me të cilat institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi. Institucioni inkurajon ndërveprimin e pedagogut me studentët edhe jashtë orarit të mësimin për lëndët, duke i ardhur në ndihmë studentit, sidomos për punimin e projekteve të zhvilluara në mënyrë të pavarur, ku ata mund të komunikojnë dhe të shkëmbejnë materiale me pedagogët. Nga biseda me studentët gjatë vizitës në institucion, GVJ, vlerëson pozitivisht disponibilitetin e pedagogëve të këtij programi studimi për ndihmën që i jepet studentëve edhe përtej orarit mesimor, duke konfirmuar ekzistencën e marrëdhënieve e respektit të ndërsjellë mes tyre. Po kështu edhe bashkëpunimi me studentët në periudhën e përgatitjeve të diplomave dëshmon për rritjen e efektivitetit në mësimnxënie (https://drive.google.com/drive/u/2/folders/lrdX9JzHx9D5MZzTkcWYyvT8hcNLëLBZi). Referenca: <i>Aneksi 25, Politikat e bashkëpunimit dhe marrëveshjet e partneritetit në funksion të programit të studimit; Aneksi 28, CV-të dhe kualifikimet e stafit të angazhuar në programin e studimit.</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Njësia përgjegjëse për programin e studimit "Art dhe Dizajn" përfshin studentët në format e metodat e vlerësimit të mësimdhënies përmes pyetësoreve periodike 2 herë në vit, ku ata vlerësojnë format e metodat e mësimdhënies. Njësia e Brëndshme e Sigurimit të Cilësisë NJBSC operon në nivel universiteti dhe drejton të gjithë procesin e vazhdueshëm të vetëvlerësimit, raportimit të rezultateve, ndjekjes së reagimit ndaj tyre me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të formave e metodave të mësimdhënies. Sigurimi i cilësisë në programin Bachelor "Art dhe Dizajn", ashtu si dhe në programet e tjera që ofron institucioni realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës, ushtrimit të kontrollit nga ana e strukturave drejtuese dhe NJBSC, tërheqjes së mendimit të studentëve, të stafit akademik, vlerësim nga kolegu, vetëvlerësim dhe nga eprorët etj. Në mënyrë

	specifike studentët japin vlerësimin e tyre mbi metodat e përdorura në klasë dhe mbi efektshmërinë e tyre. Vlerësimi i studentëve është anonim, mbi bazën e një pyetësori të strukturuar si dhe lejon mundësinë e dhënies së komenteve të hapura. Shumë i vlefshëm është edhe informacioni që merret në mënyrë periodike nga alumni i programit MSc i studimit mbi avantazhet dhe vështirësitë që mund të hasin në profesion. Referenca: <i>Aneks 17, Formularët për vlerësimin akademik dhe administrativ; Aneksi 49, Vlerësimi I stafit akademik-template.</i>			
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	NJSBC, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisioni për Kurrikulat e Mesimin, janë struktura në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e mësimdhënies. Duke patur parasysh karakterin aplikativ dhe zhvillimin e vazhdueshëm të profesionit, institucioni është i angazhuar të nxisi përdorimin e komponentëve inovativë në metodat e mësimdhënies. Në dokumentin e Strategjise së Kërkimit Shkencor duke u nisur nga temat e përgjithshme kërkimore të Fakultetit dhe të Departamentit shtjellohen metoda dhe tema të mundshme për t'u trajtuar nga studentët në punën e tyre të diplomës. GVJ, vlerëson shumë të rëndësishëm bashkëpunimin ndërkombëtar në programin ERASMUS; falë të cilit Universiteti POLIS ka hartuar udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies të bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare. Kështu, në kuadër të projektit DRIVE, i koordinuar nga Universiteti POLIS janë hartuar metodologji mësimdhënie, që nxisin aftësitë e studentëve për të kryer kërkim shkencor. Referenca: <i>Aneksi 4, Rregullore Didaktike; Aneksi 6, Rregullore Bachelor "Art dhe Dizajn". Aneksi 21, Aftësia e Kërkimit Shkencor.</i>			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson format e ndryshme që aplikohen në mësimdhënie, mësimnxënie dhe transmetimit të dijeve e njohurive në programin Bachelor "Art dhe Dizajn" pasi ato synojnë pjesëmarrjen aktive dhe kontributin e përbashkët pedagog-student. GVJ për këtë program studimi veçon format si: Punën në grup dhe "Punën në Atelie/Studio", për hartimin e projekteve në grupe mësimore, në syllabuset e lëndëve, në vizita në Atelie/Studiostudio, vizita në ekspozita, panairë, projekte etj. ku janë të përfshirë në këtë proces edhe studentët. GVJ, vlerëson shumë të rëndësishëm edhe bashkëpunimin në nivel ndërkombëtar për përfshirje në programin ERASMUS; në zhvillimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies të bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nu k pë	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

	rm bu she t			
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Në rregulloren e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Art dhe Dizajn”, është përcaktuar mënyra e vlerësimit të njohurive të studentëve përmes një sistemi kontrolli të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të komponentëve si: Frekuentimi dhe angazhimi, Detyrat javore, Provimi i Ndërmjetëm, detyra kursi dhe Provimi Final. Çdo lëndë jep specifikime të hollësishme në syllabus e saj lidhur me organizimin e provimeve dhe kriteret e vlerësimit, i cili i bëhet i ditur studentëve me fillimin e mësimeve. Kjo u evidentua edhe biseda me studentët gjatë vizitës në institucion. Referenca: <i>Aneksi 3, Rregullore e përgjithshme; Aneksi. 06 Rregullore e Programit të studimeve Bachelor “Art dhe Dizajn”; Aneksi 27/1 dhe 27/2 Syllabuset e lëndëve.</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët janë njohur me mënyrën e vlerësimit të dijeve përmes syllabusit, që i prezantohet dhe shpjegohet që në orët e para të mësimit nga stafi akademik. Gjithashtu, studenti njihet me planin mësimor, syllabusin edhe me format e detyrimeve dhe të vlerësimit, provimit dhe dorëzimit të projektit në varësi të lëndës (Frekuentimin, Angazhimin në mësime, Detyrimet javore dhe Provimin/Projektin final), si dhe me kriteret e vlerësimit (Aneksi 27/1 dhe 2, Syllabuset). Nga biseda me studentët në institucion ata konfirmojnë se kanë në dijeni për mënyrat e vlerësimit sipas lëndëve/moduleve nga pedagogët e lëndëve. Referenca: <i>Aneksi 27, Syllabuset e lëndëve sipas programit.</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi i njohurive për mësimdhënien dhe mësimnxënien realizohet në forma të ndryshme, sipas lëndëve të programit mësimorë dhe të përcaktimeve të secilës lëndë, ku vlerësohet jo vetëm rezultati në provimet përfundimtare apo në dorëzime detyrash/projekte, etj. nëpërmjet provimeve të ndërmjetme dhe pjesëmarrja aktive në klasë, në diskutime apo punë praktike. Natyra e vlerësimit të komponentëve siguron lidhje të punës së pavarur, asaj kërkimore e teorike për një formim të plotë sipas objektivave të secilës lëndë. Gjatë vizitës në institucion studentët dhe pedagogët konfirmojnë këto mënyra testimi.

	Referenca: <i>Aneksi 4, Rregullore didaktike; Aneksi 5, Rregullore e Departamentit (FAD); Aneksi 6, Rregullore e Programit mësimorë; Aneksi 27/1 dhe 24/2, Syllabuset</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	GVJ, vlerëson punën e Universitetit POLIS për vlerësimin periodik të pedagogëve, forma që i shërbejnë përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie duke përfshirë edhe studentët. Vetëvlerësimi dhe vlerësimi kanë treguar se janë të dobishme edhe për fusha specifike që përbëjnë format dhe metodat e mësimdhënies. Studentët nga ana e tyre, japin vlerësime edhe për metodat e përdorura në klasë dhe mbi efektshmerine e tyre. Vlerësimi i tyre është anonim, mbi bazën e një pyetësoi të strukturuar, i cili lejon mundësinë e dhënies së komenteve të hapura. GVJ e ka gjetur të drejtë dhe shumë të vlefshëm edhe informacionin që merret në mënyrë periodike nga alumni e programit të studimit "ART dhe Dizajn" mbi problematikat që ata mund të hasin gjatë punësimit në profesion.
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Departamenti i Art dhe Dizajnit ka ne fokus nitjen e vazhdueshme të cilësisë së formimit të studenteve, duke u ofruar tyre dijet, metodat dhe teknikat me bashkëkohore të mesimdhënies. Treguesit për efektivitetin e mekanizmave administrative vlerësohen mbi kriteret specifikë që lidhen me efektivitetin e mbështetjes së studenteve për problemet dhe vështirësitë akademike dhe personale, nepermjet Sherbimit të Mireqenies Studentore dhe me mekanizmat e mjaftueshëm ligjor administrativ për monitorimin dhe mbështetjen e studenteve. Prezantimet për tema të caktuara japin studentit mundësi të prezantohet me gjithë bagazhin e tij edukativ, si dhe të kontribojë me kerkimin e tij tek: grupi i studenteve. Gjate këtij procesi studenti mer mbështetjen e mesimdhënesit ku dalin në dukje cilësitë e respektit të ndërsjellë. Programi Bachelor "Art dhe Dizajn" nxit në zhvillimin e punës artistike dhe të dizajnit të trajtes të pavarur në cdo studio atelie i cili përbehet programi, gjithashtu dhe në zhvillimin e tezës së diplomës, iniciativa i lihet studentit. Jane studentet të cilët vijne me propozime të temës kerkimore dhe fushës së studimit dhe temave të diplomës; apo edhe të produktit në dizajn. Pra inkurajimi i autonomisë së studentit ndodh në mënyrë të vazhdueshme, inkrementale dhe ndërvetëpruese. Kjo qasje kërkon dhe gjen gadishmerine e personelit akademik për të kuptuar që autonomia e studentit krijohet falë një marrëdhënieje respekti të ndërsjellë si dhe aktualizimin e saj në koordinimin e procesit mes lendeve të ndryshme dhe me zhvillimin hap pas hapi nga vitet e para drejt viteve të fundit të procesit mësimor
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmblendës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson kriteret dhe mënyra të testimit të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve në përputhje me Rregulloren e programit të studimit "Art dhe Dizajn" ku bëjnë pjesë dhe frekuentimi, angazhimi, detyrat javore, provimi i ndërmjetëm,</i>

	detyrat e kursit dhe Provimi Final të cilat janë publike dhe njihen nga studentët, të cilat u evidentuan edhe në takimin me studentët gjatë vizitës në institucion. Gjithashtu, studenti njihet me planin mësimor, syllabusin edhe me format e detyrimeve dhe të vlerësimit, provimit dhe dorëzimit të projektit në varësi të lëndës. GVJ e ka gjetur të drejtë dhe shumë të vlefshëm edhe informacionin që merret në mënyrë periodike nga alumni e programit të studimit "Art dhe Dizajn" mbi problematikat që ata mund të hasin gjatë punësimit në profesion.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet nëpërmjet një sistemi të vazhdueshëm të kontrollit, ku nota përfundimtare rezulton prej kombinimit të komponentëve përbërës, përcaktuar në syllabuse. Sipas Rregullores Didaktike të Institucionit, testimi i njohurive, dijeve dhe aftësive pëfituara nga studentet realizohet duke vlerësuar me pikë pjesëmanjen dhe aktivizimin, detyrat e kursit, (projekte etj), laboratorët, provimet e ndërmejtme dhe provimin përfundimtar. Në nivel programi studimi, studenti vlerësohet edhe për praktikën dhe detyrimet përmblylëse për mbrojtjen e diplomës. Të gjitha rregulloret bëhen dhe janë publike e të aksesueshme nga studentët. https://universitetipolis.edu.al/akte-normative/ Referenca: <i>Aneks 4, Rregullore Didaktike; Aneksi, Syllabuset</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Kontrolli i njohurive bëhet nëpërmjet provimeve me gojë, provimeve me shkrim ose dorëzimit të projekteve të kursit. Institucioni vë në dispozicion të studentëve sisteme elektronike të ruajtjes së shënimeve të tyre, i cili është i qëndrueshëm dhe funksional siç është platforma e "Google Classroom". GVJ, u njoh edhe me specifikën që ka programi i studimit në "Art dhe Dizajn"; i cili kërkon ecurinë e zhvillimit të projekteve në mënyrë të vazhdueshme, duke mos lejuar hapësira për abuzime, por përkundrazi, lejon transparencë dhe koherencë në atë që studenti kryen në aspektin e dorëzimeve të projekteve. GVJ, vlerëson kujdesin si për kontrollet periodike të studentëve nga pedagogët ashtu dhe mënyrën e mbajtjes së tyre dhe i vlerësuar ato brenda standardeve akademike duke shmangur kështu mundësitë për abuzime.

	Referenca: <i>Aneks 3, Rregullore e Përgjithëshme e studimeve</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Mënyra e vlerësimit dhe pesha specifike e secilit komponent u bëhen të qarta studentëve nëpërmjet syllabusit të lëndës dhe bazën ligjore në fuqi. Çdo element vlerësimi shfaqet në syllabusin përkatës si dhe sistemin PITAGORA, po ashtu edhe në proces verbal të perkatese të vlerësimit të lëndës. Vlerësimi përfundimtar realizohet nga grupi i komisioneve të provimeve / projekteve Go më pak se 2 pedagogë, nën drejtimin e titullarit të lëndës, të ngritura nga departamenti dhe të miratuara nga Dekani i fakultetit. Kjo mënyrë vlerësimi na u konfirmua edhe nga studentët dhe kontrolli i procesverbaleve të ruajtura në sekretarinë mësimore.. Referenca: <i>Aneks 3, Rregullore e Përgjithëshme e studimeve</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i njohurive bëhet në përputhje me Rregulloret e Institucionit, duke vlerësuar dijet, aftësitë profesionale dhe punën individuale të studentit. Ky vlerësim përfshin forma të ndryshme si komunikimin e drejtpërdrejtë, ku stafi akademik gjatë orëve të seminarëve u ofron studentëve komente/feedback për performancën e tyre për njohuritë e fituara gjatë seminareve/punën në studio të ndërmjetme, nivelit të prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla/orinetime për përmirësime në të ardhmen. Studentit i jepet e drejta të kërkojë t'i shohin provimet e korrigjuara. Për këtë arsye, në fund të çdo provimi pedagogu organizon seanca konsultimi ku komunikohet rezultati dhe merret një feedback i përgjithshëm. Referenca <i>Aneksi 06 Rregullore e procesit mësimorë Bachelor "Art dhe Dizajn"</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Natyra e profilit të studimit në fushën e dizajnit, procesi i anonimizimit, sekretimit dhe kodifikimit të punës së studentit nuk është kriter, sepse kërkesat e paracaktuara nga pedagogu i lëndës reflektohen përgjatë gjithë procesit të punës, ku paanshmëria dhe drejtësia në vlerësim sigurohet nga hallkat e një zinxhiri i mekanizmave, që institucioni ka vendosur siç janë: prezantimi publik para kolegëve dhe komisioneve me të paktën dy anetarë i projekteve dhe detyrave të studenteve; me diskutimin dhe ankimimin e vlerësimeve dhe mostolerancën ndaj abuzimeve të natyrave të ndryshme. Për rastet kur natyra e lëndës kërkon kushte më të veçanta të testimit, institucioni aplikon infrastrukturë të nevojshme fizike dhe personel të shtuar për të garantuar monitorimin e procesit të provimeve dhe shmangur kopjimin. Në bazë të rregullores së Programit të Studimit, personeli akademik siguron zhvillimin korrekt të provimeve në lidhje me materialet e ndaluara dhe pasojat në rast të shkeljes së saj. Punët kërkimore shkencore verifikohen të gjitha në sistemin online antiplagjaturë Turnitin (https://ëëë.turnitin.com) dhe vlerësimi pozitiv nga sistemi është kusht detyrues pranues. Referenca:

	<i>Aneksi 06, Rregullore Bachelor "Art dhe Dizajn"-Protokolli i Provimit; Aneksi 60, Policies on turning.</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Kontrollet e dijeve bazohen në meritë dhe në mbarëvajtjen e gjithë procesit mësimor, i cili është i monitoruar nga institucioni. Afati kohor brenda për shpalljen e rezultateve të kontrolleve është i përcaktuar në rregulloren e programit të studimit dhe si e tillë iu bëhen me dije me mënyre individuale studentëve si në mënyrë fizike ashtu edhe dhe online. GVJ, vlerëson korrektësinë e stafit në procesin e kontrollit të dijenive, i cili ishte në përputhje me rregulloren e universitetit POLIS dhe me specifikimet e syllabuseve.
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Në bazë të Rregullores së programit të studimeve është e përcaktuar edhe e drejta e studentit për t'u njohur me rezultatet e provimit e mënyrën se si është vlerësuar puna e tij. Kur studenti pretendon se Ai nuk është vlerësuar për punën e tij, i lind e drejta të kërkojë rishikim nga komisioni i vlerësimit. Nëqoftëse edhe nga rivlerësimi i komisionit studenti konsideron që pritshmëritë e Tij nuk janë në përputhje me pretendimet e tij, atëherë sipas rregullores mund të kërkojë ngritjen e një komisioni të ri e tyë pavarur për rishqyrtimin e provimit, detyrës dhe dorëzimin e projektit. Referenca: <i>Aneksi 06, Rregullore Bachelor "Art dhe Dizajn"-Protokolli i Provimit.</i> Në rast se përsëri studenti ka dyshime dhe mendon se meriton vlerësim të ndryshëm, përsëri studenti mund të bëjë një kërkesë për ngritjen e një komisioni të posaçëm, përbërja e të cilit i bëhet e ditur. Sipas rastit të pretenduar komisionit i kërkohej shpjegime dhe sqarime të mëtejshme për punën e kryer. Ashtu si edhe në rastet e mëparshme, vlerësimi i komisionit të posaçëm, i bëhet e ditur studentit nëpërmjet sekretarisë mësimore. I gjithë ky proces është i dokumentuar dhe i arkivuar. Ashtu si edhe në rastet e mëparshme, vlerësimi i komisionit të posaçëm, i bëhet e ditur studentit nëpërmjet sekretarisë mësimore. I gjithë ky proces është i dokumentuar dhe i arkivuar
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ e konsideron të drejtë Vlerësimin e njohurive të studentëve nëpërmjet një sistemi të vazhdueshëm të kontrollit, ku nota përfundimtare rezulton prej kombinimit të komponentëve përbërës, përcaktuar në syllabuse dhe bazën ligjore në fuqi. GVJ, e konsideron të drejtë, që konsideron të drejtë, që për natyrën e këtij profili në fushën e dizajnit, procesi i sekretimit dhe kodifikimit të punës së studentit të mos jetë kriter, sepse vetë kërkesat e paracaktuara nga pedagogu i lëndës ku, paanshmëria dhe drejtësia në vlerësim sigurohet nga: prezantimi publik para studentëve dhe komisioneve me dy anetarë i projekteve dhe detyrave të studenteve; me diskutimin dhe ankimin e vlerësimeve që shmangin abuzime të natyrave të ndryshme. GVJ, vlerëson korrektësinë e stafit në procesin e kontrollit të dijenive, i cili është në përputhje me rregulloren e universitetit POLIS dhe specifikimet e syllabuseve.</i>

	<i>Procedura e ndjekur dhe e drejta e studentit për t'u njohur me rezultatet e provimit e mënyrën se si është vlerësuar puna e tij, dokumentohet dhe është transparente.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit në Bachelor “Art dhe Dizajn” siguron aftësimin e specialistëve të ardhshëm me njohuri e aftësi të thelluara profesionale, në përputhje me natyrën e lëndëve që mbulon; si në aspektet social-kulturore, ato të karakterit teorik, profesional dhe aplikativ. Departamenti si njësi bazë, siguron kushte dhe mundësi edhe për realizimin e praktikave mësimore e internshipe për studentët. Lëndët studio luajnë një rol të rëndësishëm dhe garantojnë thellim të njohurive profesionale, pasi shërbejnë edhe si aplikim të lëndëve të veçanta. GVJ vlerëson këtë rol të dyfishtë që luajnë lëndët studio.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi i studimit garanton kompetencë dhe zhvillim të aftësive profesionale në fushën e “Art dhe Dizajn”, komunikimit vizual, si dhe shkencave humane. Universiteti ofron një gamë të gjerë të mësimdhënies të kombinuara me teknologjinë e informacionit si mësimin teorik dhe leksioneve online nga profesorë të ftuar nga Universitete rajonale e ndërkombëtare në fushën e dizajnit apo bashkëpunime me kompani në projekte, ekspozita e panaire etj. Gjithashtu, Universiteti POLIS është i përfshirë në projekte për aplikimin e aplikacioneve të reja në fushën e dizajnit ku studentët e këtij departamenti aftësohen në fushën e dizajnit, duke veçuar ato më kryesoret: SPORES - "intermedial experiences" at the crossroads of arts and technology;; "Accelerating Eastern Balkans University Modernization by Incorporating Virtual Technologies/ VTECH"; Inclusive Tertiary Education in East Balkans/ IDEA; Couture - Merging Fashion and Traditions for Sustainable Style. Referenca: <i>Aneksi 40 Plani mësimor-kurrikula e programit Bachelor “Art dhe Dizajn”; Informacione nga vizita në institucion me studentë e pedagogë.</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të	Syllabuset e Programit të studimit në Bachelor “ART dhe Dizajn”, ndër të tjera janë të orientuara edhe për aftësimin e kompetencave nga studenti. Rezultatet e mësimdhënies si dhe aftësitë e fituara analizohen si gjatë zhvillimit të programit të lëndës dhe në përfundim të saj. Në prani të studentëve stafi akademik analizon rezultatet dhe bën krahasime me pritshmëritë. GVJ vlerëson diskutimin që bëhet me studentët në

lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	kuadër të feedback-ut të nevojshëm për rritjen e tyre profesionale dhe atë me stafin akademik për të vlerësuar efektshmërinë e metodave të përdorura për arritjen e objektivave që lënda parashton në sillabus. Diskutimet e kësaj natyre zhvillohen edhe në prani të përgjegjësve të programit të studimit, të departamentit dhe të dekanit për të analizuar arritjet dhe për të shkëmbyer përvojat e krahasuar rezultatet me objektivat në bazë lëndësh të veçanta, grupe lëndësh, viti akademik e programi studimi në tërësi.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Programi i Studimit <i>Bachelor</i> në “Art dhe Dizajn” ndërthur ngarkesat teorike në leksione e seminare me punën profesionale në studio. Personeli akademik mbështet punën në grup. Disa nga detyrat e kursit apo edhe projekte parashikohen të punohen në grup, me qëllim për të nxitur diskutime, komunikime, konfrontime të ideve dhe zgjidhjeve për të gjeneruar ide inovative dhe kërkime të avancuara shkencore. Gjithashtu, insitucioni nxit studentët të marrin pjesë në konkurse, për t'u ekspozuar me zgjidhje kreative dhe inovative, ashtu sikundër vetë personeli akademik ka qene i ekspozuar vazhdimisht ndaj nje ambjenti konkurues dhe inovativ me trajnime dhe i hapur për të krijuar klimën e përshtatshme për të zhvilluar kërkime të avancuara. Shpeshhere studentët e disiplinave të ndryshme, si në “Arkitekturë”, “Dizajn i Aplikuar” dhe “Art e Dizajn”, janë të ftuar në vizita në platformën “Artist dhe Dizajner Talk”, e cila afron më afër ekspertët tek studentët. Përsa i përket përgatitjes profesionale dhe zhvillimit të kompetencave të studentëve, Departamenti bashkërendon punën e tij me strukturat e tjera dhe asistuar në zhvillimin e praktikave profesionale sipas listës së partnerëve të miratuar.
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Departamenti i “Art dhe Dizajn” dhe Fakulteti i “Arkitekturës dhe Dizajnit” organizojnë orë të hapura dhe prezantime nga personeli mësimorë efektiv apo i ftuar dhe figura të shquara akademik e profesionale, aktivitete të emërtuara “Artist and Designers Talk”. Edhe vetë Universiteti POLIS në traditën e tij organizon aktivitete të emërtuar “Open Forum”. Këto platforma shfrytëzohen si për të ndarë eksperiencat më të avancuara të Dizajnit; kërkimit shkencorë; Inovacionit; Multimedia si dhe teknologjisë, ku studentët bashkëveprojnë me eksponentët më në zë të arkitekturës, dizajnit e artit. Duke palur parasysh karakterin e veçantë të këtij programi studimi “Art dhe Dizajn”, bëhen me të rëndësishme dhe të dobishme, duke mundësuar afrimin e studentëve me profesionin e lirë dhe njohjen me problematikat dhe sfidat e tregut të punës. Prezantime të tilla përmenden edhe ne RVB të këtij programi si p.sh.: Andra Mastrovito (Itali) - Artist Bashkohor; Karolina Halatek (Poloni) - Kërkuese dhe Artiste Bashkohore; Lori Lako (Shqipëri - Hali) - Artiste Bashkohore; Jeremy

	Deller (Mbreteria e Bashkuar) Artist Bashkohor; Ivan Bennet (Mbretëria e Bashkuar); Dizajner Produkti Odile Deqc (France); Dizajner Produkti; Gaetano Castelli (Itali) – Skenograf; Tiffany Cheng (USA) - Dizajner 4D - Modelim kompjuterik; Simone Sfriso (Itali) - Dizajner – Arkitekt; Matali Crassel (France) - Dizajner Produkti – Kuratore; Michela Magas (Mbreteria e Bashkuar) - Dizajner - Këshilltare për Inovacionin pranë Komisionit European; Kiersten Muenchinger (USA) - Dizajner - Pergjegjes departamenti të Dizajnit të Produktit, Oregon; Francesco Zurlo (Itali) - Dizajner Industrial - Profesor “Polytechnico di Milano etj.			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson se Programi i studimit në Bachelor “Art dhe Dizajn” siguron aftësimin e studentëve me njohuri e aftësi të thelluara profesionale, në përputhje me natyrën e lëndëve. Syllabuset e Programit të studimit në Bachelor “ART dhe Dizajn”, ndër të tjera janë të orientuara edhe për aftësimin e kompetencave nga studentit, duke iu dhënë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Institucioni i nxit dhe i mbështet studentët të marrin pjesë në konkurse, për t’u ekspozuar me zgjidhje kreative dhe inovative. GVJ, vlerëson ftesat që studentët që të bëhen pjesë e platformës “Artist dhe Dizajner Talk”, e cila i afroh më afër ekspertët tek studentët. Shembuj të tillë janë shumë, si p.sh. prezantime me Andra Mastrovito (Itali) - Artist Bashkohor; Karolina Halatek (Poloni) - Kërkuese dhe Artiste Bashkohore; Lori Lako (Shqipëri - Itali) - Artiste Bashkohore; Jeremy Deller (Mbreteria e Bashkuar) Artist Bashkohor; Ivan Bennet (Mbretëria e Bashkuar); Dizajner Produkti Odile Deqc (France); Dizajner Produkti; Gaetano Castelli (Itali) – Skenograf. etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblylëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën	Universiteti POLIS parashikon në procesin e diplomimit të studentëve një tërësi dokumentacioni të hartuara për këtë program studimi. Kështu, Rregullore e Fakultetit Arkitekturë dhe Dizajn e parashpreh procesin e diplomimit të studentëve edhe në rregulloren specifike të diplomimit; ku janë të përcaktuara detaje dhe procedura, formate dhe modalitete të mbrojtjes së diplomës për këtë program studimi. Studentët njoftohen gjithashtu edhe një herë zyrtarisht me e-mail mbi këtë procedurë në vitin e tyre të fundit të studimeve. Njoftimi detajon edhe listën e gjithë

studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	dokumentacionit të nevojshëm për t'u dorëzuar nga secili student i programit të studimeve Bachelor në "Art dhe Dizajn".
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	GVJ, vlerëson punën e gjithë strukturave përgjegjëse të institucionit, përfshirë edhe Dekanatin e FAD, departamentin "Art dhe Dizajn", personeli akademik, bibliotekën fizike dhe ajo elektronike etj., të cilat vihen në dispozicion dhe asistojnë në çdo hap të punës studentët me informacione, udhëzime, libra dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve për programin e studimit Bachelor "Art dhe Dizajn". Departamenti bazuar në rregulloren e diplomimit vendos edhe disa afate kohore për realizimin e diplomës siç janë: <i>Faza përgatitore</i> (orientimi dhe shqyrtimi i listës së studentëve të miratuar për diplomim); <i>Faza e parë</i> (paraqitja dhe miratimi i temës së diplomës); <i>Faza e dytë</i> (organizimi i zhvillimit të punimit); <i>Faza e tretë</i> (kontrollat e organizuara nga Komisioni); <i>Faza e katërt</i> (dorëzimi i punimit final dhe mbrojtja e diplomës). Dorëzimi i materialeve të diplomës bëhet pranë një komisioni të posaçëm të përbërë nga 3 persona, 2 prej të cilëve nga departamenti dhe 1 nga zyra juridike e Universitetit POLIS. Projekti finalizohet edhe me një objekt dizajni si edhe nëpërmjet një ekspozite.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Komisioni i posaçëm për organizimin e vlerësimit të diplomës vlerëson punimin e diplomës të realizuar nga studenti sipas rregullores së veçantë. Diploma e shkruar shoqërohet edhe me një objekt dizajni, të realizuar në bazë të njohurive të fituara specifike në lëndët e modulet sipas peshës së tyre specifike. Gjatë mbrojtjes së diplomës, komisioni i posaçëm pas prezantimit të studentit ka të drejtë të drejtojë pyetje specifike që lidhen me punimin e diplomës në nivelin e njohurive që i përkasin programit të studimit Bachelor "Art dhe Dizajn". Referenca: <i>Ankesi 06, Rregullore e Programit Bachelor. "Art dhe Dizajn"; Aneksi 07. Rregullore Diplomimi dhe Projekti i diplomës.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve	Udhëheqësi i punimit të diplomës udhëzon dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temës së punimit duke lejuar edhe iniciativën e lirë studentit për zgjedhje dhe shfaqjes edhe ideve të reja të tyre. Në këtë proces edhe personeli akademik i vinë në ndihmë studentit për dokumentat dhe strategjitë e institucionit. Një ndër to është axhenda e kërkimit shkencor në të cilën janë parashtruar fushat e interesit, tema që janë në zhvillim si dhe një listë me tematika kërkimore për tema të diplomave, që mund të përzgjidhen nga vetë studentët. Referenca: <i>Aneks 21, Axhenda e Kërkimit Shkencor.</i>

dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Departamenti i "Art dhe Dizajn" asiston studentët në realizimin e punëve praktike dhe produkteve fizike sipas tipologjisë tyre-mutlimediale duke vënë në dispozicion aparaturat përkatëse dhe pajisjet e prodhimit manual e dixhital të institucionit. Të gjitha mjediset e Universitetit POLIS janë në shërbim të studentëve, përfshirë edhe administratën; qendrën <i>Innovation Factory - IF</i> edhe jashtë tij, të cilat kontribuojnë për realizimin e produkteve të diplomave falë edhe aktorëve me të cilët institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi. Referenca: <i>Aneksi 16, Broshura-innovation Factory; Aneks 21.</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Universiteti POLIS ka mundësuar skanimin kundër plagjiaturës të temës së diplomave përpara procesit të mbrojtjes. Nga ana e tij, udhëheqësi i temës, pasi është bindur për cilësinë e punës dhe pasi ka marrë rezultatin e kontrollit elektronik kunder plagjiaturës (Turnitin), miraton ose jo paraqitjen e punimit para komisionit të mbrojtjes të diplomës. Në përfundim, me përmbylljen dhe mbrojtjen e diplomës studenti vlerësohet me notë nga komisioni i mbrojtjes, ku secili anëtar vlerëson punimin në mënyrë të pavarur. Vlerësimi i komunikohet studentit në prani të komisionit nga kryetari i komisionit. Referenca: <i>Aneksi 60, Policies on Turnitin.</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Me përfundimin e studimeve në Bachelor në "Art dhe Dizajn", studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga MASH, Studentëve të diplomuar, së bashku me diplomën dhe suplementin e diplomës, u ofrohet një kopje e plotë e programit zyrtar të studimit si dhe syllabus-eve të lëndëve të zhvilluara gjatë gjithë periudhës së studimit. Referenca: <i>Aneksi 18, Modeli i Diplomës dhe Suplementi i Diplomës; Aneksi 41, Model Kurs Katalogu i Programit.</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Të dhënat dhe një informacion të plotë për studentin e diplomuar ruhen në sekretarinë mësimore dhe në regjistrat themeltar. Kjo u verifikua me përzgjedhje rastësore të 2 (dy) studentëve gjatë vizitës në Institucion. Kështu, studenti mund të marrë informacion mbi të dhënat e tij në çdo kohë sipas afateve të ruajtjes së dokumenteve të përcaktuara për arkivën elektronike dhe fizike të Universitetit POLIS.
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson se rregulloren e punimit të diplomës, ku janë të përcaktuara udhëzime të qarta për studentët, që përfshijnë aplikimin për temën e diplomës, zgjedhjen dhe miratimin e udhëheqësit, kryerjen e kontrolleve të detyrueshme, dorëzimin dhe procedurën e mbrojtjes.</i>

	GVJ, vlerëson të gjitha fazat e këtij procesi me kërkesa të detajuara për studentët, që duhen plotësuar prej tyre dhe institucionit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për detyrimet përmbyllëse, udhëheqësit e diplomës, ofrojnë mbështetje në çdo hap të përgatitjes së tezës së diplomës. Studenti vlerësohet me notë nga kryetari i komisionit të mbrojtjes. Me përfundimin e studimeve në programin Bachelor në "Art dhe Dizajn", studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga MASH.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Referuar RVB, takimit me stafin akademik të angazhuar me programin e studimit si dhe takimit me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike, GVJ konstatoi që personeli akademik si dhe personeli ndihmës akademik, i angazhuar në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Personeli akademik i angazhuar me këtë PS mbulon të gjitha lëndët/modulet mësimore të programit. I gjithë aktiviteti i tij lidhet me fushën kërkimore të programit të studimit. Konkretisht, për PS Bsc në "Art dhe Dizajn", Departamenti i Artit dhe Dizajnit kishte angazhuar, sipas viteve, personelin akademik si më poshtë: 1. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë departament 21 pedagogë (nga të cilët 15 PAE dhe 6 PAK) si dhe 7 Msc të angazhuar si personel ndihmës akademik 2. Për vitin akademik 2023- 2024 kanë dhënë mësim në këtë departament 22 pedagogë (nga të cilët 16 PAE dhe 6 PAK) si dhe 8 Msc të angazhuar si personel ndihmës akademik

	3 Për vitin akademik 2024 - 2025 japin mësim në këtë departament 21 pedagogë (nga të cilët 16 PAE dhe 5 PAK) si dhe 7 Msc të angazhuar si personel ndihmës akademik Ndërsa për PS Bsc "Art dhe Dizajn", personeli mësimdhënës sipas viteve rezulton të jetë: Viti 2022-2023 gjithsej 28 nga të cilët 22 PAE/6 PAK PAE 2 Prof, 6 Dr, 14 Msc/ PAK 4 Dr, 2 Msc Viti 2023-2024 gjithsej 33 nga të cilët 27 PAE/6 PAK PAE 2 Prof, 11 DR 14 Msc/ PAK 2 Dr, 4 Msc Viti 2024-2025 gjithsej 32 nga të cilët 27 PAE/5PAK PAE 2 Prof, 1 Prof.As 10 Dr, 14 Msc/ PAK 2 Dr, 3 Msc Në vitin akademik 2024-2025 janë angazhuar si personel ndihmës akademik edhe 7 Msc. Nga PAE këne udhëhequr diploma në Bsc sipas viteve: Viti 2022-2023 3 PAE Viti 2023-2024 2 PAE Viti 2024-2025 3 PAE Ky personel mbulon ngarkesën e përgjithshme prej 12692 orësh në raportin rreth 82% PAE dhe 18% PAK, duke përmbyshur kështu detyrimin ligjor që PAE të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore (Udhëzimi i MAS nr.1, datë 14.01 2020). Lidhur me nivelin e kualifikimit të personelit akademik të angazhuar në këtë PS, GVJ konsultoi të dhënat e tabelës përmbledhëse 4 (Ngarkesa e plotë e Personelit Akademik në PS Bch "Art dhe Dizajn") dhe vlerëson që përmbyshet detyrimi ligjor i saksionuar në Ligjin 80/2015, neni 59 pika 6. Gjithashtu nga tabela 4 rezulton që ngarkesa mësimore për PAE është e shpërndarë me variacion të madh duke filluar nga 120 deri 473 orë mësimore, çfarë favorizon trajtim të diferencuar të personelit të angazhuar me këtë PS Struktura moshore për vitin 2024-2025 rezulton: 25 deri në 35 vjeç- 14 PAE dhe 0 PAK 36 deri në 45 vjeç- 10 PAE dhe 5 PAK 46 deri në 55 vjeç- 0 PAE dhe 0 PAK 56 deri në 65 vjeç- 1 PAE dhe 0 PAK Mbi 66 vjeç- 2 PAE dhe 0 PAK
--	---

	Shihet që peshën kryesore e merr mosha mesatare 36-45 vjeç (10 PAE) dhe pastaj mosha 25 deri 35 vjeç (14 PAE) duke siguruar kështu perspektivë të mirë për qëndrueshmërinë e personelit të angazhuar në PS Bch “Art dhe Dizajn” Po ashtu gjatë vizitës në institucion, në takimin me personelin akademik si dhe konsultimit të dokumentave të DVV, GVJ konstatoi që mbulimi i lëndëve/moduleve të programit nga ana e personelit mësimdhënës përputhet me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Tabelat përmbledhëse - Aneks 14_Guida e Stafit - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Programi i studimit Bch në “Art dhe Dizajn” zhvillohet në 3 vite shkollorë (6 semestra). Plani mësimor përmban gjithsej 34 lëndë/përkatësisht module. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Pesha që zënë kategoritë respektive për këtë PS janë: Kategoria A 20% (Lëndë Bazë) Kategoria B 53.3% (Lëndë karakterizuese) Kategoria C 13.0% (Lëndë ndërdisiplinore/integruese) Kategoria D 18% (Lëndë plotësuese) Kategoria E 3.3% (Detyrime përmbyllëse) E gjithë ngarkesa prej 180 ECTS mbulohet nga PAE në masën rreth 82% dhe PAK në masën rreth 18% duke përmbyllur kështu detyrimin ligjor që PAE të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore (Udhëzimi i MAS nr.1, datë 14.01 2020) <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Tabelat përmbledhëse - Aneks 3_Rregullore Përgjithshme - Aneks 44_Strategjia e Burimeve Njerëzore - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit,	Referuar të dhënave numerike mbi personelin akademik të angazhuar në PS Bch “Art dhe Dizajn” në vitet akademike 2022-2023, 2023-2024, 2024-2025, përkatësisht 22, 27 dhe 27 si dhe peshës që zë mosha 25-46 vjeç në Bch “Art dhe Dizajn” (rreth 89%), konkludohet në plotësimin e këtij kriteri. <i>Referenca:</i>

duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	-RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Tabelat përmbledhëse - Aneks 45 _Model kontrate PAK-PAE - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Referuar materialeve të DVV, vizitës në zyrën e burimeve njerzore, takimit me personelin akademik dhe konsultimit të faqes zyrtare në internet të Universitetit Polis https://universitetipolis.edu.al/punesimi/. GVJ konstaton që në këtë IAL ndiqen të gjitha procedurat ligjore të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit, të cilat garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion --Tabelat përmbledhëse - Aneks 46 _Formular per shpalljen e vendit kandidat - Aneks 47 _Formular vlerësimi gjatë procesit të rekrutimit - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Referuar CV-ve të personelit ndihmës akademik të angazhuar me PS, Bch në “Art dhe Dizajn”, ngarkesës në syllabuset e lëndëve, përkatësisht moduleve, aktiviteteve mësimore dhe vizitave në auditoret, labororet dhe studiot ku zhvillohet procesi mësimor, GVJ konstaton që Universiteti Polis siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Tabelat përmbledhëse - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të	Për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin çdo vit akademik të të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit Bch në “Art dhe Dizajn” në universitetin Polis, është përgjegjëse zyra e Burimeve Njerzore dhe Çështjeve Juridike, e cila disponon bazën e plotë për të gjithë personelin akademik të angazhuar në PS së bashku me dokumentacionet e nevojshme ligjore.. GVJ i konsultoi burimet e të dhënave për këtë kriter dhe konstaton plotësimin e tij. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Tabelat përmbledhëse

personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	- Annex 14 Guida e Stafit https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion GVJ konsultoi listën prej 52 institucionesh dhe organizatash me të cilat Universiteti Polis bashkëpunon në nivel institucional. GVJ shqyrtoi marrëveshjet me të gjitha institucionet përkatësisht organizatat dhe ndërmarrjet me të cilat bashkëpunohet për PS Bch “Art dhe Dizajn” dhe kontaton që në të gjitha rastet objekti i bashkëpunimit është kryerja e praktikave profesionale. Në takimin me studentët ata pohuan vlerat e këtyre bashkëpunimeve duke theksuar në veçanti realizim produktesh konkrete në interes të entiteteve ku është kryer praktika <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Tabelat përmbledhëse - Aneks 42_Institucionet dhe organizatat ne bashkepunim ne nivel institucional - https://ëëë.universitetipolis.edu.al/
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Për PS Bch “Art dhe Dizajn” janë nënshkruar 21 marrëveshje me objekt bashkëpunimi “praktikat profesionale”. Gjatë takimit me studentët, GVJ u informua që personeli mbikqyrës në ambientin pritës i angazhuar në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve i ka ndihmuar ata jo vetëm në përmbushjen e detyrimeve (raportin përfundimtar të praktikës) por edhe duke marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre, referuar edhe produkteve të realizuara konkretisht gjatë kësaj periudhe. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 43_Formulari për kryerjen e praktikës - https://www.universitetipolis.edu.al/
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që tek Universiteti Polis personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush plotësisht standardet lidhur me angazhimin e personelit me tituj dhe grada shkencore. GVJ nisur nga ngarkesa disi e shbalancuar e PAE rekomandon balancimin e saj duke konsideruar edhe një ngarkesë në masën 300 deri 360 orë mësimore.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Duke shqyrtur dokumentacionin e DVV si dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që Universiteti Polis siguron ambiente për zhvillimin e aktivitetit mësimor e kërkimor shkencor, në vartësi të numrit të studentëve dhe grupeve mësimore. Po ashtu duke marrë parasysh veçoritë e PS Bsc “Art dhe Dizajn” ofrohen edhe ambiente të dedikuara për konkretizimin e njohurive dhe ekspozimi. Gjatë vizitës në institucion GVJ vizitoi ambientet e vëna në dispozicion për PS Bsc “Art dhe Dizajn” dhe konstaton që si auditorët ashtu dhe studiot e mjediset laboratorike janë të paisura me paisjet dhe teknologjitë e duhura për zhvillimin me cilësi të procesit mësimor. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Tabelat përmbledhëse - <u>Anekset 26.-ambientet</u> - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ konstaton që ky kriter plotësohet në nivel bashkëkohor. Të gjitha auditorët, klasat, studiot dhe laboratorët ishin të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantonin realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. GVJ vizitoi të gjitha ambientet në dispozicion të PS “Art dhe Dizajn”. Në takimin me studentët, ai u informua që metodat e mësimdhënjes ishin edhe të larmishme dhe efiente. Këtu theksojmë se, në verifikim të plotësimit të rekomandimeve të lëna nga Bordi i Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.1, datë 01.02.2019, GVJ gjeti që institucioni kishte përmirësuar laboratorët aktualë të: CAD, MAC, Qeramikës, Pikturës/Ilustrimit, Prototipizimit dhe Fotografisë me paisje dhe shërbime plotësuese dhe cilësore. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Tabelat përmbledhëse - <u>Anekset 26.ambientet</u>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	- https://www.universitetipolis.edu.al/			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimi teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	GVJ vizitoi laboratorët e Pikturës/Ilustrimit, fotografisë, Prototipizimit kompjuterave, sallën shumëfunksionëse etj të cilët përdoren për modelim origjinalësh, prodhim dhe analizë fotografish, ekspozime të punimeve të studentëve, printime 3D etj. Po ashtu ai u informua dhe për përdorimin nga ana e studentëve të këtij programi të mjediseve funksionale në sipërmarrjet e institucionet bashkëpunuese. Aftësimi praktik i studentëve të PS Bch “Art dhe Dizajn” shprehet edhe në ekspozitat e hapura me punimet e tyre, ku edhe publiku jep vlerësimin e tij. Duke parë cilësinë e produkteve të ekspozuara edhe në mjediset e institucionit konstaton që ato edhe pse të realizuara në procesin mësimor janë në nivel të tillë sa mund të ofrohen edhe në treg. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Tabelat përmbledhëse - Anekset 26.ambientet - https://www.universitetipolis.edu.al/			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Ky kriter plotësohet pasi Universiteti Polis vë në dispozicion të programeve të studimit klasa dhe laboratore të paisura me PC dhe programe profesionale edhe për natyrën e PS Bch “Art dhe Dizajn”. Disa nga këto programe integrohen edhe në paisjet e laboratorit “Innovation Factory” si një njësi multidisiplinore. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Tabelat përmbledhëse - Anekset 26.ambientet - https://www.universitetipolis.edu.al/			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Polis përpos vënjes në dispozicion të mjediseve të tij për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit Bch “Art dhe Dizajn” garanton, nëpërmjet marrveshjeve me sipërmarrje që kanë aktivitet dizajnimi edhe kryerjen me cilësi të praktikave profesionale në kushtet e sipërmarrjes.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi IV.3

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Për plotësimin e këtij kriteri GVJ shqyrtoi sylabuset për tu njohur me ofertën e literaturës nga ana e pedagogëve. Nga shqyrtimi i syllabuseve dhe gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit, GVJ konstaton që literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. Ky konstatim mbështetet edhe nga studentët, në takimin që GVJ organizoi me to. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Tabelat përmbledhëse - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua hollësisht mbi fondin e pasur të bibliotekës, bashkëpunimin e frytshëm edhe me Departamentin e Artit dhe Dizajnit për të përditësuar dhe pasuruar fondin e saj, masën e përdorimit të literaturës nga studentët, konsiderimin e sugjerimeve e kërkesave të pedagogëve dhe studentëve si dhe dobinë e abonimit nga institucioni në libraritë digjitale JSTOR dhe EBSCO të cilat garantojnë dhe përditësim të literaturës <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Tabelat përmbledhëse - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Ky kriter plotësohet pasi Universiteti Polis ka një bibliotekë me sipërfaqe prej 155 metra katror. Qëllimi i saj është për të mbështetur aktivitetet arsimore, shkencore dhe kërkimore të stafit akademik dhe të studentëve. Gjatë vizitës në ambientët e bibliotekës, GVJ konstaton që ajo përbëhet nga seksione dedikuara programeve të studimit ku, në njërin prej tyre ndodhej edhe literatura për PS Bch “Art dhe Dizajn”. Biblioteka kishte një kapacitet prej 50 vendesh, pjesën e literaturës fizike me rreth 10 000 libra, aksesimin në bibliotekat on-line dhe njesinë administrative të Bibliotekës. Biblioteka garanton mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë të fondit, ofertës dhe ambienteve të saj edhe nga studentët e programit të studimit Bch “Art dhe Dizajn”. Nga biseda me studentët, GVJ u informua që ata ishin të kënaqur me shërbimin e bibliotekës. <i>Referenca:</i> -RVB



	-Shënime nga vizita në Institucion - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në ambientet e bibliotekës GVJ konstatoi që ajo ishte e me pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit Bch “Art dhe Dizajn” Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Ky kriter plotësohet nëpërmjet abonimit që ka bërë institucioni në libraritë dixhitale JSTOR dhe EBSCO. Të gjithë studentët mund të hynin në këto biblioteka duke përdorur e-mailin e tyre të dedikuar me domein @universitetipolis.edu.al. Po ashtu këto biblioteka shfrytëzoheshin edhe nga personeli akademik si burim i rëndësishëm për përgaditjen e leksioneve, dispensave dhe zhvillimin e aktivitetit të tyre kërkimoro-shkencor. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që biblioteka është e paisur me programe kompjuterike dhe teknologji të tjera, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët që e frekuentojnë atë. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Në universitetin Polis biblioteka qëndron e hapur prej orës 08.30 deri në orën 16.30. Biblioteka ishte e hapur edhe të shtunën e të dielën në orarin 09.00-17.00. Gjatë takimit me studentët ata pohuan për GVJ se ishin të kënaqur me shërbimet e bibliotekës. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit	Në takimet me personelin akademik dhe studentët si dhe gjatë vizitës në bibliotekë, GVJ u informua për cilësinë e fondit fizik dhe fondit

ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	online të saj. Ata pohuan që fondi përditësohej në mënyrë të vazhdueshme dhe se përdorimi i tij ishte efektiv në plotësimin e nevojave, kryesisht me literaturë profesionale (libra dhe revista). Sugjerimet dhe kërkesat e tyre përcilleshin edhe në department edhe direkt tek personeli i bibliotekës dhe merreshin në kondisera të prej tyre me përparësi. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.universitetipolis.edu.al/			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbljedhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që edhe për programin e studimit Bch "Art dhe Dizajn" biblioteka e institucionit ofron literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Universiteti Polis qysh prej vitit 2019, disponon sistemin e menaxhimit në platformën "Pitagora". Nëpërmjet këtij sistemi administrohet i gjithë informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomim. Çdo student ka llogarinë e tij të dedikuar në këtë sistem. Në takimin me studentët, GVJ u informua që ky sistem funksionon në mënyrë të pandërprerë dhe i plotëson të gjitha kërkesat për shërbimet që u nevojiten atyre. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://polis.pitagora.rash.al/login - https://www.universitetipolis.edu.al/

Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi "Pitagora" administron edhe informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit të studimit Bch "Art dhe Dizajn". Në takimin me personelin akademik, GVJ u informua që ky system funksionon në mënyrë të pandërprerë dhe i plotëson të gjitha kërkesat për shërbimet që u nevoiten atyre. Duke qenë se sistemi "Pitagora" shërben si sistem i menaxhimit të brendshëm në universitetin Polis, ai siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit Bch "Art dhe Dizajn". <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://polis.pitagora.rash.al/login - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit "Pitagora" është i instaluar në platformën Google në faqen https://polis.pitagora.rash.al/login dhe arrihet nëpërmjet adresës së dedikuar për çdo individ. Ai përmban module insertimi, leximi dhe editimi, të cilat mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://polis.pitagora.rash.al/login - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i menaxhimit "Pitagora" garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Informacionet jepen nëpërmjet domenit https://www.universitetipolis.edu.al/, i cili i afishon ato në rubrika të posaçme. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://polis.pitagora.rash.al/login - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit	Universiteti Polis ka domenin e tij në internet, platforma google, i cili arrihet në adresën https://www.universitetipolis.edu.al/. Në këtë adresë gjenden të gjitha informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme në rang institucioni, njësisht kryesore, njësisht përgjegjëse, programesh studimi, partnerët



në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	strategjikë etj. GVJ e vizitoi këtë faqe dhe konstaton plotësimin e kriterit. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://polis.pitagora.rash.al/login - https://www.universitetipolis.edu.al/			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Polis disponon sistemin e brendshëm të menaxhimit institucional Pitagora dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ edhe për programin e studimit Bch "Art dhe Dizajn".			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Referuar RVB dhe vizitës në Universitetin Polis, GVJ konstaton që ky institucion harton një raport financiar të kostove dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshëm për mbarëvajtjen e njësisë përbërse të tij, ku përfshihet edhe Departamenti i "Artit dhe Dizajnit" si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Bch "Art dhe Dizajn". Raporti financiar dhe plani mbështetës hartohen çdo vit duke marrë në konsideratë të gjitha shpenzimet e vitit të kaluar dhe të gjitha nevojat e kërkesave për vitin në vazhdim. Procedura që ndiqet është konform dispozitave ligjore që përcaktojnë raportimet mbi shpenzimet, të ardhurat dhe planifikimin e buxhetit. GVJ konsultoi tabelën 18 "Të ardhurat dhe financimet e ndryshme" ku evidentohen të ardhurat sipas zërave të specifikuar për tri vitet e fundit. Nga tabela del që të ardhurat kryesore rreth 90.5 % sigurohen nga zëri "Tarifat për dhe gjatë shkollimit". Pësia që merr ky zë në totalin e përgjithshëm është indikacion për sigurimin e perspektivës së programit të studimit. Duke marrë në konsideratë përvojën e krijuar nga ky institucion në rekrutimin e studentëve edhe për PS Bch "Art dhe Dizajn" (sipas viteve akademike 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023 dhe 2023-2024 numri i kontigjentit hyrës në program është respektivisht 70,70,82,88,96), konkludohet që rritjes së kontigjentit hyrës në vite i është kushtuar vëmendje e veçantë në mënyrë që programi Bch në "Art dhe Dizajn" të përmbushë edhe nevojat për financime. GVJ rekomandon fuqizimin




	e burimeve të tjera financiare me qëllim që të rritet siguria në jetëgjatësinë e programit. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Tabelat përmbledhëse - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Burimet e financimit në universitetin Polis janë: tarifat e studentëve (kryesisht), grantet për kërkim dhe kontratat si dhe të ardhura të klasifikuara si “të tjera”. Në përqindje mesatare për tre vitet e fundit vlera e tyre është respektivisht 90.5 %, 7.3% dhe 2.2%.Të gjitha fondet e siguruara shërbejnë për financimin e burimeve njerëzore akademike e administrative në shërbim të realizimit të programeve, burimeve infrastrukturore logjistike dhe didaktike si dhe investime afatgjata ku hyjnë paisje për klasa, mjete didaktike, laboratore etj. Strukturë e shpenzimeve në univeristetin Polis për 3 vitet e fundit ka qenë: Shpenzime për burime njerzore, akademike dhe administrative që i shërbejnë PS 65%. Shpenzime operative, mbështetje për procesin mësimor, pasurimin e bibliotekës, përdorimin e biblioteks dixhitale, mirmbajtje etj 27% Shpenzime ku përfshihen investimet në paisje, orendi, kompletim klasa dhe laboratore 8%. Duke analizuar strukturën e burimeve të të ardhurave dhe atë të shpenzimeve si dhe numrin mesatar të studentëve të rregjistruar në këtë PS për tre vitet e fundit (rreth 89 studentë), GVJ gjykon që institucioni dhe njësitë përbërse të tij duhet të përpiqen të shtojnë peshën e të ardhurave nga grantet për kërkim dhe kontratat si dhe të zërit “të tjera” në mënyrë që të zvogëlohen të ardhurat nga tarifat e studentëve. Po ashtu duhet të forcohet më tej puna për rritjen e numrit të rekrutimeve. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Tabelat përmbledhëse - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua që pasqyrat financiare të Universitetit Polis auditohen nga një kompani e huaj. Raportet e auditimit konfirmojnë vërtetësinë dhe pasqyrimin e drejtë të informacionit financiar. Auditimi është edhe një kusht i domosdoshëm për aplikime në projekte ndërkombëtare. Institucioni gjykon që burimet financiare janë të mjaftueshme dhe të shpërndara mirë në zërat e



	shpenzimeve për të përmbushur kërkesat dhe nevojat e aktivitetit mësimor e shkencor edhe në PS Bch "Art dhe Dizajn". <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Tabelat përmbledhëse - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Gjatë vizitës në universitetin Polis, GVJ u informua që ky institucion raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse, Departamentin e Artit dhe Dizajnit, për programin e studimit Bch "Art dhe Dizajn", mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. GVJ mësoi gjithashtu që institucioni ka hartuar një strategji për të rritur më tej të ardhurat dytësore në mënyrë që të ulët riskun e "goditjeve" nga rënjet e përkohshme të numrit të studentëve, nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes në projektet e financuara nga donatorë si EU, IIK, SIDA etj. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Tabelat përmbledhëse - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Referuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ u informua që universiteti Polis përpara fillimit të çdo viti, përveç buxhetit vjetor harton edhe një parashikim financiar me afate 3 dhe 5 vjeçare. Bazuar në këto parashikime ai bën edhe përditësim vjetor për të koregjuar parashikimet në mënyrë që të gjenden burimet e nevojshme të financimit. Ai e bazon qëndrueshmërinë financiare në tre shtylla kryesore: • Ruajtja dhe përmirësimi i reputacionit për të rritur rekrutimet • Optimizimi i burimeve njerzore, infrastrukture e profesionale për të ulur kostot dhe rritur performancën • Diversifikimin e programeve të studimit për të krijuar një portofol që siguron uljen e riskut nga ulja e numrit të përgjithshëm të studentëve si dhe shtrirjen përtej aktivitetit akademik të burimeve financiare si rritja e pjesëmarrjes në projekte e grante, lidhje më të forta me biznesin për të fituar më shumë mbështetje prej tij etj. Në kontekstin e PS Bch "Art dhe Dizajn" GVJ sugjeron përshpejtimin e ritmeve në këto drejtime për të ulur sa më shumë riskun e mosvazhdimin të këtij programi. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Tabelat përmbledhëse

	- https://www.universitetipolis.edu.al/			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kritereve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Polis në stadin aktual garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. GVJ gjykon që në perspektivë, nëse zvogëlohet numri të studentëve, tarifat e studimit ose mund të bëhen të papërbalueshme ose jo interesante në raport me konkurrencën prandaj GVJ sugjeron diversifikimin e mëtejshëm të burimeve financiare në mënyrë që të ardhurat nga tarifat e studentëve të mbeten të përballueshme prej tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE


Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Referuar DVV, RVB dhe takimeve gjatë vizitave në institucion, GVJ konstaton që U-Polis harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Hapja e programeve të studimeve bazohet në ligjin nr 80/2015 duke konsideruar specifikat e sejcilit program të hartuara nga departamenti përkatës. Programi miratohet nga senati akademik. Universiteti Polis shpall në adresën e tij në internet programet e akredituara. Rekrutimi i studentëve në këto programe bëhet bazuar në aktet ligjore të universitetit. GVJ konsultoi “Rregulloren didaktike” dhe konstaton që kreu IV i kësaj rregullorje përmban të gjitha procedurat e pranimit të studentëve ku përfshihen dispozitat e përgjithshme, aplikimi, aplikimi për rregjistrim, testi, shpallja e rezultateve, rregjistrimi dhe transferimi. Të gjitha këto procedura publikohen për tu vënë në dispozicion të të interesuarve. Për studentët, në veçanti, njohja me procedurat fillon me javën orientuese. Në këtë kohë ai “miqësohet” edhe me ambientet mësimore si dhe shërbimet që ofron veçmas institucioni. E gjithë ecuria e procesit të diplomimit për çdo student dokumentohet dhe ruhet në

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjimn. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	institucion, pa afat. Në takimin me studentët GVJ u informua se ata i njihnin këto procedura dhe konfirmonin që zbatimi i tyre ishte në dobi të gjithë aktivitetit të tyre në institucion. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 1 Statuti i Universitetit POLIS - Aneks 4 Rregullore Didaktike - Aneks 6 Rregullore e programit të studimit - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Jo vetëm në dokumentacionin e konsultuar por edhe në takimet në insitucion, kryesisht gjatë takimit me studentët, GVJ konstaton që politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit Bch “Art dhe Dizajn”. Si të drejtat ashtu edhe detyrimet ishin të njohura nga studentët edhe nëpërmjet dokumentacionit të publikuar nga institucioni, edhe nga veprimtaria konkrete që zhvillohej gjatë kohës së studimeve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të konsulencës nga zyrat përkatëse (ZMSKK). <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4 Rregullore Didaktike - Aneks 6 Rregullore e programit të studimit -Aneks 35 Rregullore ZMSKK - Aneks 34 Guida e Sudentit - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Referuar DVV, RVB dhe vizitës në institucion GVJ u informua që U-Polis bazuar në kërkesat e MAS, rregulloren didaktike, rregulloren e programit Bch “Art dhe Dizajn”, me propozim të departamentit të Artit dhe Dizajnit, miratim të fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajnit dhe vendim të Senatit Akademik, përcakton kriteret e pranimit dhe kuotat e pranimit për kandidatët që duan të studiojnë në PS Bch “Art dhe Dizajn”. Universiteti disponon gjithë infrastrukturën e nevojshme për të transmetuar tek kandidatët informacionin e duhur lidhur me planin mësimor, lëndët/modulet, syllabuset etj duke filluar me broshura, fletëpalosje, ZMSKK, faqen zyrtare të institucionit në adresën www.universitetipolis.edu.al , rrjetet sociale etj. Në takimin me studentët, GVJ konstaton që ata janë njohur me kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe në plotësim të tyre kanë filluar studimet në PS Bch “Art dhe Dizajn” <i>Referenca:</i> -RVB



	-Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4 _Rregullore Didaktike - Aneks 6 _Rregullore e programit të studimit - Aneks 34 _Guida e Sudentit Aneks 35 _Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Lidhur me plotësimin e këtij kriteri GVJ konstaton që procedurat dhe kriteret e pranimit të studentëve në Bch “Art dhe Dizajn” janë përcaktuar në Rregulloren e Programit, faqen zyrtare të institucionit, rrjetet sociale të universitetit etj. Ata u jepen studentëve edhe nëpërmjet takimeve që kërkojnë ata, kryesisht tek ZMSKK. Në zbatim të kërkesave dhe dispozitave ligjore Universiteti Polis u ofron studentëve mundësinë për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve midis programeve të të njejtit cikël studimi. Vendimin për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet e merr Komisioni i Ekuivalentimit të Krediteve ngritur nga njësia bazë (Departamenti) në përputhje me aktet nënligjore të institucionit. Gjatë takimit me studentët GVJ u informua mbi transferimin e studimeve të 3 studentëve. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4 _Rregullore Didaktike - Aneks 6 _Rregullore e programit të studimit - Aneks 34 _Guida e Sudentit Aneks 35 _Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Duke iu referuar dokumentacionit të konsultuar, informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion dhe publikimeve në faqen zyrtare https://www.universitetipolis.edu.al/, GVJ konstaton plotësimin e këtij kriteri. Të gjitha kërkesat referohen në dispozitat ligjore dhe interesat e institucionit për të tërhequr kontigjente sa më cilësorë. Për kandidatët e pranuar shërben Zyra e Pranimeve, e cila u jep atyre informacione të detajuara për universitetin dhe njësitë e tij si dhe për programin e studimit përkatës. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4 _Rregullore Didaktike - Aneks 6 _Rregullore e programit të studimit - Aneks 34 _Guida e Sudentit Aneks 35 _Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/

Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Për të siguruar një shërbim të dedikuar e sa më cilësor kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, GVJ u informua që Universiteti Polis, nëpërmjet ZMSKK dhe Zyrës së Projekteve është partner në projektin IDEA, që ka për objekt përmirësimin e aksesit, krijimin e kushteve të mësimit dhe zhvillimin e mundësive të punësimit për këtë kategori kandidatësh. Po ashtu Institucioni ka krijuar edhe një staf që vlerëson kapërcimin e pengesave që lidhen me këto kandidatë. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4 _Rregullore Didaktike - Aneks 6 _Rregullore e programit të studimit - Aneks 34 _Guida e Studentit - Aneks 35 _Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Për kandidatët që vijnë nga shtetet e tjera dhe kërkojnë të përfshihen në PS Bch “Art dhe Dizajn”, hartohen dhe publikohen përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Publikimi i këtyre kriterëve bëhet në institucion (në vende të dukshme brenda korpusit), në faqen zyrtare të universitetit, lajmërimeve të dedikuara me e-mail si dhe mediat sociale. GVJ konsultoi faqen zyrtare të universitetit dhe gjeti aty informacionet e kërkuara. Sidoqoftë deri tani nuk ka patur asnjë student të huaj si kontigjent i këtij programi studimi. Karakteristikë e rekrutimeve në këtë PS ishte objektivi i kandidatëve për të arritur të futen sa më shpejt në tregun e punës, i cili, siç pohuan vetë studentët shpreh interesim për to. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4 _Rregullore Didaktike - Aneks 6 _Rregullore e programit të studimit - Aneks 34 _Guida e Studentit - Aneks 35 _Rregullore ZMSKK
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Referua DVV, RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton që në Universitetin Polis janë hartuar kriteret lidhur me kandidatët që vijnë nga shtresa të marginalizuara të shoqërisë. Për të përkrahur këta studentë por edhe për të inkurajuar studentët e shkëlqyer institucioni ndjek politika lehtësuese financiare të cilat konsistojnë në subvencionimin e programeve të veçanta dhe reduktimin e tarifës së shkollimit. Për plotësimin e këtij kriteri GVJ konsultoi dhe faqen zyrtare online të universitetit ku në zërin “Bursa studimi” jepen kategoritë që përfitojnë dhe kriteret që duhet të plotësojnë.

	Kategoritë: 1. Studentë Ekselentë; 2. Studentë nga e njëjta familje; 3. Studentë nga shtresat sociale në nevojë Kriteret e fitimit të bursës: a) Studentët e shkëlqyer • që kanë mesatare (VKM) mbi 9 (nëntë) – dërguar nga AKP dhe në përputhje me mesataren e shënuar në diplomën e shkollës së mesme; • që kanë marrë në testin e përgjithshëm, të organizuar pranë U_POLIS, minimumi 70 % (shtatëdhjetë për qind) të pikëve totale. • që dallohen si talente në konkurime dhe evente garuese të Polis ose të tjera kombëtare/ndërkombëtare duke e provuar këtë me dokumentacion. b) Studentët nga e njëjta familje: Motër – Vëlla; Motër – Motër; Vëlla – Vëlla; Prind – Fëmijë të cilët janë në të njëjtën certifikatë familjare; dhe Burrë – Grua; c) Shtresat sociale në nevojë: Fëmijët jetim; Fëmijët e policëve të rënë në krye të detyrës; Fëmijë nga komuniteti rom; Fëmijë nga familje në pamundësi ekonomike; Studentë që konsiderohen invalid, sipas parashikimeve ligjore; etj. Gjatë takimit me studentët në pyetjen: sa prej jush janë me bursë si studentë ekselentë? -nga 27 pjesëmarrës rreth 14 prej tyre ishin me bursë. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 34_Guida e Studentit Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Polis harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen,

	përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve si dhe diplomimin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Për plotësimin e këtij kriteri, GVJ konsultoi fillimisht “Rregulloren e Programit”, “Rregulloren Didaktike”, “Rregulloren e diplomimit” dhe “Guidën e studentit” nga ku konstaton që ata japin një informacion të plotë e të qartë mbi kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Qysh në momentin e fillimit të vitit akademik, në javën e parë mbahet ceremonia e hapjes, ku studentëve të çdo programi studimi u jepet informacion i plotë për të gjitha programet. Në takimin me studentët, GVJ u informua për disponimin nga ana e tyre e informacionit të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Këtë shërbim ata e marrin edhe nga interneti, ku gjendet i përfshirë në sistemin interaktiv të universitetit “Pitagora”. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Aneks 4_Rregullore Didaktike -Aneks 6_Rregullore e programit të studimit -Aneks 34_Guida e Studentit -Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në dokumentacionin bazë të institucionit jepen informacionet që lidhen me kriteret dhe procedurat e njohjes të kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Këto informacione merren edhe tek zyrat përkatëse të institucionit si Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës apo në faqen zyrtare të universitetit. Në takimin me studentët, GVJ u informua për procedurën e ndjekur në njehsimin e numrit total të krediteve të marra kur kandidati kërkon transferim. Për statistikë numri i transferimeve në këtë PS për 6 vitet e fundit është 1. (Tabela 21) <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	- Aneks 4 <i>Rregullore Didaktike</i> - Aneks 6 <i>Rregullore e programit të studimit</i> - Aneks 34 <i>Guida e Sudentit</i> Aneks 35 <i>Rregullore ZMSKK</i> - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Informacioni për studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive jepet qysh në ditët e javës së parë. Po ashtu në “Guidën e studentit” ata gjejnë informacionet e kërkuara për këtë rubrikë. Më tej informacionet merren edhe në faqen zyrtare të institucionit në internet në adresën https://www.universitetipolis.edu.al/ duke kërkuar profilin përkatës të studimit, në platformën “Pitagora” dhe nëpërmjet postës së dedikuar elektronike. GVJ i konsultoi këto burime informacioni dhe në takimin me studentët konfirmoi që ata kishin informacionin e duhur lidhur me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4 <i>Rregullore Didaktike</i> - Aneks 6 <i>Rregullore e programit të studimit</i> - Aneks 34 <i>Guida e Sudentit</i> Aneks 35 <i>Rregullore ZMSKK</i> - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Për plotësimin e këtij kriteri GVJ shqyrtoi “Rregulloren e Diplomimit” në të cilën përcaktohet procedura e diplomimit që nga momenti i aplikimit për temën, miratimi i temës dhe pedagogut udhëheqës nga departamenti, procesi i shkrimit të tezës deri në formatimin specifik të punimit, dorëzimit, vlerësimit dhe mbrojtjes. Si specifikë e këtij programi është projekti final, i cili sipas rregullores së diplomimit do të jetë një objekt konkret dizajni paraqitur nëpërmjet paneleve të caktuara nga Udhëheqësi i Studios së Diplomës si dhe finalizimi nëpërmjet një ekspozite. Në takimin me studentët GVJ u informua për procedimin konkret gjatë punës për mbrojtjen e tezës së diplomës. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4 <i>Rregullore Didaktike</i> - Aneks 6 <i>Rregullore e programit të studimit</i> - Aneks 34 <i>Guida e Sudentit</i> Aneks 35 <i>Rregullore ZMSKK</i> - https://www.universitetipolis.edu.al/.pdf
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i	Në universitetin Polis ky kriter plotësohet duke organizuar për studentët ditët e hapura të dedikuara për çdo program studimi në mënyrë që studentët të njihen më nga afër me infrastrukturën e universitetit,

arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	ambjentet laboratorike, studiot, kurrikulën e programit, akreditimin institucional etj. Po ashtu studentët paisen me guidën e studentit si dhe u rekomandohen rubrikat përkatëse të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Universiteti Polis merr pjesë edhe në panaiet informuese të organizuara në qytetet e ndryshme të vendit apo të organizuara nga Bashkia Tiranë, ku përveç përfaqësuesve të zyrës së pranimeve është i pranishëm edhe një përfaqësues i personelit akademik, për të informuar mbi ofertat mësimore të universitetit. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 34_Guida e Studentit Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbljedhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që Universiteti Polis vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bch "Art dhe Dizajn". Informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Referuar Rregullores së Programit të Studimi Bch "Art dhe Dizajn", GVJ konstaton që aty përcaktohen kushtet për aplikim dhe pranim në këtë program studimi. Informimi për studentët nis qysh në fillim të vitit akademik ku në një seksion të veçantë prezantohet mënyra e organizimit të PS, kohëzgjatja, ndarja e lëndëve/moduleve, tipet e veprimtarive formuese, koncepti i krediteve ECTS, format e mësimi teorik e praktik, zhvillimi i mësimi, frekuentimi, përmbajtja e syllabuseve etj. Këtë informacion studentët e gjejnë edhe tek "Rregullorja Didaktike", "Guida e studentit" si dhe në faqen zyrtare të institucionit. Gjatë takimit me studentët, GVJ konstaton që ata i kanë të gjitha informacionet e kërkuara. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion



	- Aneks 4 <i>Rregullore Didaktike</i> - Aneks 6 <i>Rregullore e programit të studimit</i> - Aneks 34 <i>Guida e Sudentit</i> Aneks 35 <i>Rregullore ZMSKK</i> - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentët njihen me planin mësimor të profilin të tyre, syllabuset e çdo lënde, veprimtaritë përkatëse mësimore (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, detyra) dhe procedurat e vlersimit të njohurive. Këto informacione u transmetohen atyre në mënyrë të vazhdueshme qysh me fillimin e programit të studimeve e deri në diplomim. Sipas profilin të tyre, studentët udhëzohen ti gjejnë këto informacione edhe në faqen zyrtare të institucionit. Gjatë takimit me studentët GVJ konstaton që ata i zotërojnë të gjitha informacionet e kërkuara. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4 <i>Rregullore Didaktike</i> - Aneks 6 <i>Rregullore e programit të studimit</i> - Aneks 34 <i>Guida e Sudentit</i> Aneks 35 <i>Rregullore ZMSKK</i> - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nëpërmjet Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK) studentët informohen mbi mundësitë e punësimit si dhe mbështeten institucionalisht për orientimin drejt tregut të punës. Uiversiteti Polis është edhe partner në platformën “Gradua”, e cila është ngritur në kuadër të projektit Erasmus+ dhe synon të mbështesë universitetet dhe studentët shqiptarë të konsultojnë një sistem interaktiv të dhënash dhe një model që përputhet me kërkesën dhe ofertën e punësimit të të diplomuarve. Platforma mundëson: • Përdorimin e lirë të saj duke krijuar një CV profesionale (me kalimin e kohës kjo CV pasurohet me aktivitete që kryen i diplomuari) e cila është e dukshme për kompanitë dhe institucionet e interesuara. • Qasjen pa vështirësi në informacionin për mundësitë e punësimit, praktikave profesionale, kurseve të trajnive që ofrohen nga kompani dhe biznese të ndryshme. • Aplikim direkt për vende pune nga antarët e platformës Sipas statistikave të institucionit për vitin 2022-2023 (tabela 23) shkalla e punësimit rezulton: rreth 90% e studentëve të diplomuar janë punësuar në përputhje me diplomën dhe vetëm rreth 10 % janë punësuar jo në përputhje me diplomën. Këto tregues dëshmojnë kërkesën e lartë që ka tregu për studentët që përfundojnë studimet në PS Bch “Art dhe Dizajn”.

	<i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4 _Rregullore Didaktike - Aneks 6 _Rregullore e programit të studimit -Aneksi 30 Tabelat përmbledhëse - Aneks 34 _Guida e Sudentit - Aneks 35 _Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Të gjithë studentët e PS e Bch "Art dhe Dizajn" kanë akses në sistemin interaktiv të universitetit "Pitagora", ku gjejnë të gjitha informacionet për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor si dhe logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Po ashtu, në dispozicion të tyre janë edhe zyrat përkatëse në institucion të cilat i ofrojnë këto shërbime sa herë u kërkohen nga të interesuarit. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 19 _Manuallet e Perdorimit PITAGORA - Aneks 34 _Guida e Sudentit - Aneks 35 _Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Ky kriter plotësohet me aksesin që kanë të gjithë studentët e PS Bch "Art dhe Dizajn" në sistemin "Pitagora", si dhe në faqen zyrtare të universitetit Polis. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 19 _Manuallet e Perdorimit PITAGORA - Aneks 34 _Guida e Sudentit - Aneks 35 _Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Polis vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bch "Art+Dizajn" informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																			
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konsultoi tre regjistrat që duhet të disponohen në këtë sekretari sipas Udhezimit Nr.16,date 08.07.2019 për “Pajisjen e institucioneve te arsimit te larte me regjistrin themeltar te studenteve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave”. Nga shqyrtimi i tyre, GVJ konstaton që Universiteti Polis disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit Bch “Art dhe Dizajn”. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Aneksi 30 Tabelat përmbledhëse - Aneks 34 Guida e Sudentit - https://www.universitetipolis.edu.al/																																			
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Plotësimi i këtij kriteri dëshmohet nga shqyrtimi i regjistrave që ndodhen në sekretarine mësimore. GVJ konstaton që regjistrat plotësohen rregullisht, me shënime të qarta, pa korregjime dhe konform udhëzimit Nr.16,date 08.07.2019. Referuar të dhënave që morëm në sekretarinë mësimore numri i studentëve për programin e studimit Bch “Art dhe Dizajn” është si vijon: <table><tr><th>Viti akademik</th><th>Te regjistruar për herë të parë</th><th>Të transferuar</th><th>Të larguar</th><th>Të diplomuar</th></tr><tr><td>2019-2020</td><td>70</td><td></td><td></td><td>70</td></tr><tr><td>2020-2021</td><td>70</td><td></td><td></td><td>70</td></tr><tr><td>2021-2022</td><td>82</td><td></td><td></td><td>82</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>88</td><td>1</td><td></td><td>89</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>96</td><td></td><td></td><td>96</td></tr><tr><td>2024-2025</td><td>81</td><td></td><td></td><td>81</td></tr></table> <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Aneksi 30 Tabelat përmbledhëse - https://www.universitetipolis.edu.al/	Viti akademik	Te regjistruar për herë të parë	Të transferuar	Të larguar	Të diplomuar	2019-2020	70			70	2020-2021	70			70	2021-2022	82			82	2022-2023	88	1		89	2023-2024	96			96	2024-2025	81			81
Viti akademik	Te regjistruar për herë të parë	Të transferuar	Të larguar	Të diplomuar																																
2019-2020	70			70																																
2020-2021	70			70																																
2021-2022	82			82																																
2022-2023	88	1		89																																
2023-2024	96			96																																
2024-2025	81			81																																



Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	GVJ konsultoi sistemin interaktiv të informacionit në platformën “Pitagora” që menaxhohet nga sekretaria mësimore dhe konstaton që të dhënat për studentët menaxhohen të plota, të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme dhe aksesueshme nga personat e autorizuar. Çdo student kishte adresë të dedikuar për këtë sistem. Në takimin me studentët ata u shprehën se të gjitha të dhënat që kërkojnë menaxhohen nga platforma “Pitagora” funksionimi i të cilës është konforma dispozitave ligjore. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 19_Manualet e Perdorimit PITAGORA -Aneksi 30 Tabelat përmbledhëse - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Plotësimi i këtij kriteri realizohet nëpërmjet akteve të brendshme organizative për mënyrën e kontrollit të gjendjes dhe dokumentacionit që lidhet me studentët dhe veprimtaritë përkatëse të tyre. Për këtë qëllim, me vendim të Rektorit, në fund të çdo viti akademik ngrihet një grup ad hoc, i cili ka si objekt kontrollin e saktësisë të mbajtjes së informacionit në të gjitha njësitë administrative duke hartuar një raport analitik mbi situatën dhe përmirësimet e nevojshme që duhet të ndërmerren për rritjen e cilësisë së ofruar në shërbimet akademike përkatësisht administrative. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi realizimin e kësaj procedure dhe plotësim të këtij kriteri.. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4 _Rregullore Didaktike - Aneks 6 _Rregullore e programit të studimit - Aneks 8 _Rregullore NJBSC - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ u interesua për statistikën që disponohen mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve në programin mësimor Bch “Art dhe Dizajn” dhe referuar statistikave (Tabela nr.23) konstatohet disponimi i evidentimit. Po ashtu në shqyrtim të dokumentacionit të DVV si dhe gjatë vizitave në Sekretarinë Mësimore, ZMSKK dhe Alumnit, GVJ mësoi që shkalla e punësimit të studentëve të këtij PS në përputhje me diplomën për vitin 2022-2023 është rreth 90% ndërkohë që shkalla e përgjithshme e punësimit është 100%. Këto të dhëna përmbaheshin në raportet analitike. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion

	- Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 8_Rregullore NJBSC -Aneksi 30 Tabelat përmbledhëse - https://www.universitetipolis.edu.al/			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që Universiteti Polis mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit Bch "Art dhe Dizajn", nga pranimit deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në shqyrtim të DVV, GVJ konsultoi të gjitha dokumentat që lidhen me përfshirjen dhe angazhimin e studentëve, përkatësisht përfaqësuesve të tyre, në organet vendimmarrëse e këshilluese, mbështetur me akte ligjore dhe rregullatore të Universitetit Polis. Në Statutin e institucionit thuhet që studentët janë pjesë e organeve vendimmarrëse të universitetit, duke përmbushur kështu një detyrim ligjor që rrjedh nga ligji për arsimin e lartë 80/2015. Po ashtu në rregulloren e PS Bch "Art dhe Dizajn" tek neni 9 është përcaktuar që: Studenti ka të drejtë të përfaqësohet në Senatin Akademik në përputhje me Statutin e Universitetit. Në zbatim të këtyre detyrimeve, në Universitetin Polis funksionojnë "Senati studentor" si dhe "Klubet Studentore". Në faqen zyrtare të Universitetit Polis statusi i senatit studentor jepet si vijon: Senati Studentor" është pjesë e strukturës të Universitetit POLIS që ushtron veprimtarinë e tij në koordinim me organet drejtuese të Universitetit. Qëllimi kryesor i Senatit Studentor është angazhimi dhe aktivizimi i studentëve në aktivitete që lidhen ngushtë me veprimtaritë akademike, por dhe me të tjera që promovojnë jetën aktive dhe sociale të studentëve. Senati ka Statutin e tij, është autonom, mbështetet nga Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës dhe përfaqëson zërin e studentëve në unanimitet. U_POLIS ka një Përfaqësues Studenti të zgjedhur përmes një procesi demokratik nga komuniteti bazuar në rregulloren e tij. Çdo studim/program ka përfaqësuesin/ët e tij, duke përmbushur proporcionalitetin përfaqësues

	të 1 Përfaqësuesi për 30 studentë. Ndërsa për klubet studentore thuhet: Në POLIS funksionojnë “Klubet” e pavarura por që ndajnë së bashku vlerat, misionin dhe filozofinë e përbashkët të U_POLIS. Në vijim jepet edhe fusha e aktivitetit të tyre. Referuar këtyre angazhimeve të studentëve GVJ konstaton plotësimin e këtij kriteri. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Në takimin me studentët, GVJ u interesua të informohej për mendimin që kishin ata lidhur me “forcën” e zërit të tyre në organet ku ata përfaqësoheshin dhe konstaton që vlerësimi i tyre ishte i lartë. Pra, ata ndjeheshin të përfaqësuar plotësisht në vendimmarrjen, këshillimin apo vlerësimin mbi procesin akademik. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 8_Rregullore NJBSC - Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Në takimin me studentët, GVJ u interesua të informohej për përfshirjen e tyre në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe se a reflektoheshin sugjerimet e kontributi i tyre në to. Në përgjigje të këtij interesimi GVJ mësoi për përfshirjen dhe kontributin e studentëve kryesisht gjatë procesit të anketimeve <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4_Rregullore Didaktike - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 8_Rregullore NJBSC - Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të	Në takimin me studentët, GVJ u interesua të informohej sa konsiderohej dhënia e mendimit të tyre për barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, ankimimit të rezultatit si dhe rishikimit e reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. Në përgjigje të këtij interesimi studentët e informuan GVJ



dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	për konsiderimin e plotë të të gjithë problematikave që ngrinin lidhur me vlersimin. Ata pohuan njohjen dhe ndjekjen e të gjitha procedurave që kanë të bëjnë me vlersimin. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Aneks 4_Rregullore Didaktike -Aneks 6_Rregullore e programit të studimit -Aneks 8_Rregullore NJBSC -Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kritereve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Polis përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Procedurat dhe njësitë e posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve në Universitetin Polis janë ngritur e funksionojnë mbi bazën e Statutit të Universitetit, “Rregullores së Përgjithshme, “Rregullores Didaktike” si dhe dispozitave të tjera ligjore në zbatim të përcaktimeve të ligjit 80/2015. Njësia e posaçme që mërret me informimin e studentëve dhe mbështetjen e tyre është Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK). Në takimin me studentët, GVJ u informua që ata ishin mjaft të kënaqur me shërbimet e kësaj njësie. Po ashtu Senati Studentor ka për detyrë të përfaqësojë studentët dhe të përcjellë në organet kompetente të institucionit problemet që i shqetësojnë dhe të marrë përsipër zgjidhjen e tyre. Senati i informon studentët për përcjelljen dhe realizimin e kërkesave të tyre. GVJ konstatoi realizimin e kësaj detyre nga Senati Studentor. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion



	- Aneks 4 <i>Rregullore Didaktike</i> - Aneks 6 <i>Rregullore e programit të studimit</i> - Aneks 8 <i>Rregullore NJBSC</i> - Aneks 34 <i>Guida e Studentit</i> - Aneks 35 <i>Rregullore ZMSKK</i> - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Sistemi i posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit në Universitetin Polis lidhet më së pari me aksesin në Sistemin Interaktiv “Pitagora”. Në këtë sistem çdo student ka adresë të dedikuar, e cila funksionon mbi bazën e adresës së E-Mail-it në domenin https://www.universitetipolis.edu.al/. Në adresën e E-Mail-it dhe në rubrikat e sistemit “Pitagora” studenti informohet, merr këshilla, ndjek përparimin e tij dhe asistohet për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Po ashtu në këtë sistem përfshihen edhe ZMSKK, sekretaria mësimore, koordinatorët e programeve të studimit etj. Në takimin me studentët GVJ konstaton se ata ishin të kënaqur me funksionimin e sistemit për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4 <i>Rregullore Didaktike</i> - Aneks 6 <i>Rregullore e programit të studimit</i> - Aneks 8 <i>Rregullore NJBSC</i> - Aneks 34 <i>Guida e Studentit</i> - Aneks 35 <i>Rregullore ZMSKK</i> - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të	Gjatë vizitës në Universitetin Polis, GVJ u takua dhe me përfaqësues të Zyrës së Mbështetjes së Studentëve e Këshillimit të Karrierës (ZMSKK) për tu njohur konkretisht me aktivitetin e saj në dobi të informimit dhe orientimit të studentëve, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. GVJ konstaton se shërbimet e kësaj zyre janë efektive dhe me interes për studentët. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 4 <i>Rregullore Didaktike</i> - Aneks 6 <i>Rregullore e programit të studimit</i> - Aneks 8 <i>Rregullore NJBSC</i> - Aneks 34 <i>Guida e Studentit</i>

tjera dhe orientimin në tregun e punës.	- Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	GVJ konsultoi statistikën e Zyrës së Mbështetjes së Studentëve e Këshillimit të Karrierës dhe mësoi që rreth 90% e studentëve të diplomuar janë punësuar në përputhje me diplomën dhe vetëm rreth 10% janë punësuar jo në përputhje me diplomën (periudha 2022-2023), ndërkohë që shkalla e përgjithshme e punësimit është 100%. Këto tregues u vihen në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe dëshmojnë kërkesën e lartë që ka tregu për studentët që përfundojnë studimet në PS Bch “Art dhe Dizajn”. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 34_Guida e Studentit - Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Polis ka procedurë e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Duke shqyrtuar DVV, RVB dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që Universiteti Polis, nëpërmjet NjSBC, aktiviteti i së cilës disiplinohet e funksionon mbështetur në rregulloren e kësaj njësie, harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies referuar edhe PS Bch në “Art dhe Dizajn”. Ajo është përgjegjëse për “skanimin” e situatës lidhur me cilësinë dhe kompetentë për hartimin e strategjive lidhur me përmirësimin e saj. Për këtë ajo harton raporte në çdo fund

	semestri dhe, në koordinim me departamentet dhe dekanatet në nivel institucional, diskuton mbi konstatimet e gjetura dhe rekomandon masat për përmirësim mbështetur në strategjinë e zhvillimit të institucionit për vitet 2021-2026. Realizimin e kësaj strategjie e gjen qysh tek mjediset ku zhvillohet aktiviteti mësimor e kërkimor-shkencor, në kompozimin e planit mësimor, në hartimin e syllabuseve të çdo lënde, në rekrutimin e një personeli akademik dhe administrativ me nivel të lartë kualifikimi, dhe në cilësinë e të gjitha shërbimeve. Në takimin me studentët, GVJ u informua për vlersimin e tyre ndaj metodave të mësimdhënies duke shprehur konsideratat të larta. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 16_Broshura_Innovation Factory_IF_Strategy - Aneks 34_Guida e Studentit - Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Njësia kryesore dhe njësia bazë e PS Bch "Art dhe Dizajn" janë përkatësisht "Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit" dhe "Departamenti i Artit dhe Dizajnit". Këto struktura përgjegjëse kanë zhvilluar mekanizma monitorimi dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. GVJ konsultoi dokumentat e mëposhtme: Vlerësimi i kolegut për kolegun, Formular për vlerësimin, Vetëvlerësim i performances së lektorit, Pyetësor për vlerësimin e pedagogut nga studentet, Formular për vlerësimin e proceseve administrative dhe konstaton që këto formularë plotësohen periodikisht dhe kanë ndikimin e duhur në vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit. Për një vlerësim edhe më objektiv të aktivitetit të personelit akademik nga ana e studentëve, GVJ rekomandoi kategorizimin e dy grupeve studentësh bazuar në rezultatet e tyre: ata me rezultate të larta (psh me mesatare mb8) veç dhe të tjerët veç. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 16_Broshura_Innovation Factory_IF_Strategy - Aneks 34_Guida e Studentit - Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave	Universiteti Polis garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe vlerësimin të dijeve, si dhe mundësinë e trajtimit të ankimeve, më së pari



e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	nëpërmjet trajtimit të ankesave të tyre. Kjo procedurë bazohet në përcaktimet detyruese të “Rregullores Didaktike”. Më tej nëpërmjet plotësimit të një pyetësi të posaçëm, i cili është depozituar si dokument edhe në platformën “Pitagora” studentët japin vlersimet si dhe shprehin mendimet e tyre për çdo lëndë të frekuentuar. Po kështu, duke plotësuar “Pyetësin për vlerësimin e pedagogut nga studentet” i cili përbëhet nga 10 pyetje, ku kërkohen vlersime të studentëve lidhur me performancën e pedagogëve në mësimdhënie, fitohet një tablo e qartë për angazhimin e PAE/PAK dhe marrdhëniet e tyre me auditorin. GVJ konsultoi këtë pyetësor si dhe u interesua të informohet nga studentët lidhur me përfshirjen e tyre në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve si dhe trajtimin e ankimimeve dhe vlerëson plotësimin e këtij kriteri. Por në këtë kuadër GVJ rekomandoi që përgjigjet ndaj pyetësorit të studentëve të merren veç e veç duke i ndarë studentët në dy kategori (grupe) siaps rezultateve të tyre: ata me rezultate të larta (psh mbi 8) dhe ata me rezultate poshtë mesatares 8. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 16_Broshura_Innovation Factory_IF_Strategy - Aneks 34_Guida e Studentit - Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Publikimi i rezultateve të të gjitha gjetjeve të anketimit bëhet në faqen zyrtare të Universitetit Polis si “RAPORTI VJETOR (për vlerësimin e procesit mësimor nga studentët)”. GVJ e konsultoi faqen zyrtare të institucionit dhe konstaton publikimin e të dhënave e rezultateve të anketimit. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 16_Broshura_Innovation Factory_IF_Strategy - Aneks 34_Guida e Studentit - Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për	Në “Raportin Vjetor (për vlerësimin e procesit mësimor nga studentët)” analizohet situata lidhur me performancën dhe në fund, në rubrikën “Përfundime e Rekomandime” evidentohen gjetjet dhe rekomandohet trajtimi i tyre. <i>Referenca:</i> -RVB



përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	-Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 16_Broshura_Innovation Factory_IF_Strategy - Aneks 34_Guida e Studentit - Aneks 35_Rregullore ZMSKK - https://www.universitetipolis.edu.al/			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kritereve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Polis ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ konstaton që në Universitetin Polis është ngritur e funksionon Sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përputhje me nenin 103 të Ligjit nr. 80/2015. Mbi këtë bazë janë hartuar aktet rregullatore të institucionit si Statuti, Rregullorja Didaktike, Rregulloret e Njërive Kryesore, Rregulloret e Programeve të Studimeve etj, të cilët kanë prodhuar strukturën e cilësisë ku përfshihen Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) dhe Komisioni i Rishikimit të Kurrikulave. Kjo strukturë ka si produkt funksionimin, zhvillimin dhe realizimin e procesit mësimor e kërkimor-shkencor me nivel të tillë cilësie, që të diplomuarit e tij të kërkohen dhe të pranohen nga tregu i punës vendas dhe i huaj. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit te programit - Aneks 17 Formularët e vlersimit - Aneks 8_Rregullore NjBSCK - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin	Nga shqyrtimi i RVB, DVV si dhe të gjitha produktet e Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, GVJ gjykon që institucioni e ka të ngritur dhe e mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. E gjithë struktura e tij zbaton strategjinë institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, duke përfshirë edhe studentët edhe ekspertë të jashtëm si anëtarë të kësaj strukture.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gim. "Q. Stafa", Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	<i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit të programit - Aneks 17 Formularët e vlersimit - Aneks 8_Rregullore NjBSCK - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Akreditimet nga ASCAL të Universitetit Polis janë kryer sipas dispozitave ligjore për arsimin e lartë në vendin tonë. Gjetjet dhe rekomandimet e këtyre akreditimeve, mbështetur në treguesit e cilësisë të realizuar prej tij, kanë shërbyer në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë edhe për PS Bch “Art dhe Dizajn”. GVJ shqyrtoi rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.1 datë 01.02.2019 dhe konstaton konsiderimin dhe plotësimin e tyre. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit të programit - Aneks 17 Formularët e vlersimit - Aneks 8_Rregullore NjBSCK - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Referuar DVV, RVB dhe vizitës në Universitetin Polis, GVJ konstaton përdorimin e treguesve të qartë për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore të institucionit. Këto tregues pasqyrohen në raportet periodike që harton institucioni dhe njësitë përbërse të tij. Ato janë të publikuar në adresën e faqes zyrtare të Universitetit Polis https://www.universitetipolis.edu.al/, kështuqë mund të konsultohen prej cilitdo të interesuari, i cili pas konsultimit konstaton që ky institucion, mbështetur në treguesit cilësorë bën promovime nxitëse për arritjet më të mira edhe në programin e studimit Bch “Art dhe Dizajn”. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit të programit - Aneks 17 Formularët e vlersimit - Aneks 8_Rregullore NjBSCK - https://www.universitetipolis.edu.al/
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbljedhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Polis harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë

	së programit të studimit, në kuadër të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	GVJ konsultoi fillimisht DVV, që ka shërbyer si bazë e punës së Grupit të Vlersimit të Brendshëm për hartimin e RVB dhe konstatoi që kjo dosje përmban dokumentat e përcaktuara në aktet ligjore për evidentimin e nivelit të cilësisë në PS Bch “Art dhe Dizajn” . Në vazhdim, gjatë vizitës në institucion, u kërkuar edhe disa dokumenta shtesë. Në shqyrtim dhe në analizë të gjithë këtyre materialeve, GVJ konstaton që dokumentat e prodhuara i shërbejnë akreditimit të PS. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 12 Strategjia e zhvillimit të programit - Aneks 17 Formularët e vlersimit - Aneks 32 Raporti Vjetor NJSBC 2023-2024 - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	GVJ konstaton që në RVB, të prodhuar nga Grupi i Vlersimit të Brendshëm (GVB) si dhe në gjithë dokumenatcionin e prodhuar nga zbatimi i akteve rregulluese ligjore përfshihen rezultate vlersimi, motivohen praktikatat dhe arritjet më të mira, pasqyrohen masat e marra për përmirësimin në vijim të cilësisë si dhe motivohen arritjet më të mira në procesin mësimor dhe kërkimor shkencor nga i gjithë personeli akademik i angazhuar me PS Bch “Art dhe Dizajn” . <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 12 Strategjia e zhvillimit të programit - Aneks 17 Formularët e vlersimit - Aneks 32 Raporti Vjetor NJSBC 2023-2024 - https://www.universitetipolis.edu.al/

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	GVJ konstaton që vizitat në auditore, si një metodë e drejtpërdrejtë vlersimi, evidentojnë probleme që kanë të bëjnë me komunikimin e pedagogëve me auditorin, aktivizimin e studentëve, përdorimin e kohës në mësimdhënie etj. Përveç këtij vlersimi një rol të rëndësishëm luan edhe evidentimi i rezultateve të pyetsorit për vlersimin e lektorëve nga ana e studentëve. Pyetjet e anketimit në këtë formular lidhen me performancën e lektorit në auditor, ku me sistemin e pikëve nga 1 deri 5 nxirren konkluzione e merren masa për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në mësimdhënie. Pësia e këtij vlersimi është 50%. GVJ konsultoi faqen zyrtare të institucionit dhe konstatoi kryerjen periodike të këtij vlersimi. Më tej procesi i vlersimit tek U_Polis realizohet edhe me vlersimin midis kolegëve ku kolegu vlerëson kolegun (pësia e këtij vlersimi në performancë është 35%) dhe vetëvlersimin (me pësia 15%) ku çdo lektor jep vlersimin për veten e tij. Në kuadër të vlersimeve përfshihen edhe vlersimi nga drejtuesit, vlersimi me sondazhe, vlersimet me ballafaqim me tregun e punës etj Në këtë kuadër GVJ rekomandon anketimin e studentëve në dy nivele: të studentëve me mesatare mbi 8 dhe të studentëve me mesatare më të vogël se 8. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 12 Strategjia e zhvillimit të programit - Aneks 17 Formularët e vlersimit - Aneks 32_Raporti Vjetor NJBSC 2023-2024 - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që Universiteti Polis monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.</i>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Referuar Ligjit 80/2015 si dhe akteve rregullatore ligjore të institucionit që burojnë nga zbatimi i këtij ligji, Statutit dhe Rregulloreve të tij, GVJ konstaton që në Universitetin Polis, në politikat dhe procedurat lidhur me sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së PS Bch “Art dhe Dizajn”, parashikohet dhe garantohet përfshirja e aktorëve të brendshëm e të jashtëm. Kështu në organet që merren me sigurimin e cilësisë, si aktorë të brendshëm janë edhe studentët. Kontrolli i cilësisë bëhet periodikisht edhe nga ASCAL nëpërmjet akreditimeve. <i>Referenca:</i> - RVB - Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 6 Rregullore e programit të studimit - Aneks 17 Formularët e vlersimit - Aneks 8 Rregullore NjBSCK - Aneks 52 Internal Quality Assurance Strategy 2023-2027 - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në aktet ligjore dhe rregullatore të institucionit përcaktohen të drejta dhe detyrime për të gjithë aktorët që merren me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në zbatim të këtyre përcaktimeve ligjore kryhen auditime të vazhdueshme rezultatet e të cilave publikohen edhe në Raportin Vjetor të Institucionit. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që përgjegjësi dhe detyra konkrete në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit Bch “Art dhe Dizajn” kanë: Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit, Departamenti i Artit dhe Dizajnit, Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit, Staf i akademik i rekrutuar për mësimdhënien, Staf i administrativ i rekrutuar për shërbimet. Të gjithë këto përbërës, përfshirë edhe studentët, me angazhimin e tyre në vlersim të mësimdhënies dhe arritjes së rezultateve në përvetësimin e dijeve që ofron Universiteti, realizojnë detyrimet e tyre në sigurimin e brendshëm të cilësisë. GVJ gjykon që ky kriter për PS Bch “Art dhe Dizajn” plotësohet tërësisht. <i>Referenca:</i> - RVB - Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 6 Rregullore e programit të studimit

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-13423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	- Aneks 17 Formularët e vlersimit - Aneks 8_Rregullore NjBSCK - Aneks 52_Internal_Quality_Assurance_Strategy_2023-2027- - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	GVJ, duke shqyrtuar DVV dhe RVB si dhe gjatë takimeve në institucion, gjykon që njësitë përgjegjëse për PS Bch “Art dhe Dizajn”: Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit; Departamenti i Artit dhe Dizajnit si dhe drejtuesit e tyre janë të angazhuar për sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Ata, nëpërmjet përcaktimit të qartë të detyrave e përgjegjësi, kontrollit të zbatimit të tyre, respektimit të afateve kohore në realizimin e përgjegjësi, në bashkëpunim edhe me studentët, kanë krijuar një trupë aktive, puna e së cilës është shpërblyer me rezultate të larta si gjatë viteve të studimit ashtu e, kryesisht, në tregun e punës. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 17 Formularët e vlersimit - Aneks 8_Rregullore NjBSCK - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Si aktorë të brendshëm në proceset e vlersimit të PS Bch “Art dhe Dizajn” konsiderohen Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit, Departamenti i Artit dhe Dizajnit, stafi akademik, stafi administrativ si dhe studentët. Duke shqyrtuar DVV si dhe gjatë vizatave në institucion GVJ konstaton që të gjithë këta aktorë janë përfshirë në procesin e vlersimit dhe detyrat që ata kanë kryer, kanë qenë të barazvlefshme në cilësi duke shmangur diskriminimin dhe pabarazinë. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 17 Formularët e vlersimit - Aneks 8_Rregullore NjBSCK - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me	Si aktorë të jashtëm në procesin e vlersimit konsiderohen përfaqësues nga sipërmarrjet ku janë punësuar të diplomuarit e këtij programi studimi, antarët e Aluminit, ekspertët e akreditimit si dhe publiku i interesuar dhe i informuar mbi këtë program. GVJ konstaton që të gjithë këta aktorë kanë dhënë kontributin e tyre me ekspertizë e mendime të çmuara në lidhje me cilësinë dhe përmirësimin e saj. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion



cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	- Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 17 Formularët e vlersimit - Aneks 8_Rregullore NjBSCK - https://www.universitetipolis.edu.al/			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kritereve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Polis përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Bch "Art dhe Dizajn" janë dokumentuar në aktet ligjore e nënligjore të Universitetit Polis. Në pikpamje të realizimit, ato përbëjnë sfida të mëdha, kryesisht me konkurrencën jashtë vendit lidhur me kontigjentet dhe tregun e punës. Instituti ka interes që këto elementë të aktivitetit të tij të jenë transparente e të njihen gjerësisht. Për këtë, përveç botimeve në fashikuj të veçantë përfshirë në dokumentat bazë të institucionit ato janë publikuar edhe në faqen zyrtare të institucionit https://www.universitetipolis.edu.al/. Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit të programit - Aneks 17 Formularët e vlersimit - Aneks 48_Raporti Vjetor 2023-2024 - Aneks 52_Internal_Quality_Assurance_Strategy_2023-2027 - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Universiteti Polis i ka botuar rezultatet e e vlerësimeve për Bch "Art dhe Dizajn" në kapituj të veçantë të përfshirë në dokumentat bazë të institucionit apo raportet vjetore, si broshura më vehte si dhe në faqen zyrtare të institucionit https://www.universitetipolis.edu.al/. Gjatë vizitës në institucion, kryesisht në takimin me Personelin Akademik, GVJ u interesua për respektimin e lirisë dhe etikës akademike dhe

	konstatoi respektimin e tyre. Po ashtu është respektuar dhe legjislacioni për ruajtjen e të dhënave personale. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit të programit - Aneks 17 Formularët e vlersimit - Aneks 48_Raporti Vjetor 2023-2024 - Aneks 52_Internal_Quality_Assurance_Strategy_2023-2027 - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Në raportet vjetore, por edhe në analizat lidhur me rezultatet e vlerësimit, janë hartuar plane masash që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. GVJ konstaton që raportet e vlerësimit të jashtëm shqyrtohen nga drejtuesit e njësive përgjegjëse, përkatësisht programeve të studimit, të cilët kanë kompetencën dhe përgjegjësinë, në zbatim të detyrimeve ligjore, të hartojnë plane veprimi duke caktuar objektiva dhe afate konkrete. Plane veprimi hartohen edhe duke adresuar gjetjet e anketimeve si anketimet për vlersimin e lektorëve etj. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit të programit - Aneks 17 Formularët e vlersimit - Aneks 48_Raporti Vjetor 2023-2024 - Aneks 52_Internal_Quality_Assurance_Strategy_2023-2027 - https://www.universitetipolis.edu.al/
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Universiteti Polis, nëpërmjet strukturave të tij, që lidhen direkt me vlersimin e cilësisë shqyrton akte dhe procedura të cilat miratohen nga Senati Akademik. Pas miratimit, zbatimi i këtyre akteve dhe procedurave është i detyrueshëm. GVJ gjykon që procesi i zbatimit ka qenë efektiv dhe ka çuar në përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë edhe në PS Bch “Art dhe Dizajn ” <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit të programit - Aneks 17 Formularët e vlersimit - Aneks 48_Raporti Vjetor 2023-2024 - Aneks 52_Internal_Quality_Assurance_Strategy_2023-2027 - https://www.universitetipolis.edu.al/

Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Në shqyrtim të DVV dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që Universiteti Polis organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre në sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Në takimin me personelin akademik, psh u pohua që rezultatet e anketimeve ndikojnë direkt në ndërgjegjësimin e tyre lidhur me natyrën e gjetjeve dhe motivimin e tyre për tu ngjitur më lart në nivelet e vlersimit. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - Aneks 6_Rregullore e programit të studimit - Aneks 12_Strategjia e zhvillimit të programit - Aneks 17 Formularët e vlersimit - Aneks 48_Raporti Vjetor 2023-2024 - Aneks 52_Internal_Quality_Assurance_Strategy_2023-2027 - https://www.universitetipolis.edu.al/			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që në Universitetin Polis politikën, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë edhe për programin e studimit Bch "Art dhe Dizajn" janë publike, transparente dhe efektive, dhe synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Art dhe Dizajn” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Polis”

Pikat e forta dhe afirmime

- 1) Plani mësimor i Programit të Studimit “Art dhe Dizajn” ka formuar kontigjente të mirëpritura nga tregu i punës, duke dëshmuar kështu vlerat didaktike si në fushën e mësimdhënjes ashtu edhe në atë të mësimnxënjes.
- 2) Mjediset mësimore dhe ato të praktikimit e konkretizimit profesional për këtë PS janë të bollshme, të mirëpaisura dhe funksionale. Ata u krijojnë studentëve mundësi të mira për të qenë të vëmendshëm në studim dhe kreativë në konkretizim.
- 3) Numri relativisht i lartë dhe i qëndrueshëm i kontigjentit hyrës (mesatarisht 89 studentë në tre vitet e fundit) ka ndikuar shumë pozitivisht në angazhimin e përkushtuar si të personelit akademik mësimdhënës ashtu edhe të mbështetjes institucionale ndaj këtij programi.
- 4) Konsiderimi i rekomandimeve të Bordit të Akreditimit ka ndikuar po ashtu pozitivisht sidomos në mirëpaisjen e laboratorëve e studiove, duke i ngritur ato në nivelin e mjediseve shumë funksionale për konkretizimin e njohurive.
- 5) Falë nivelit të përvetësimit të njohurive teorike e konkretizimit të tyre në mjediset e universitetit, studentët e këtij programi studimi janë të mirëpritur pothuajse të gjithë në tregun e punës sapo mbarojnë vitin e dytë të studimeve Bachelor.
- 6) Cilësia e kontigjentit hyrës (mesatarja e 6 viteve të fundit 8.2) përbën një shtysë të fuqishme për rritjen e cilësisë së mësimdhënjes në këtë program studimi.
- 7) Përvoja shumëvjeçare e punësimit të kontigjenteve të PS Bch “Art dhe Dizajn” e bën atë të synuar dhe të vlerësuar nga ata që duan të vazhdojnë studimet për art dhe dizajn.
- 8) Personeli akademik efektiv, ai me kontratë dhe ai ndihmës akademik i angazhuar në këtë program studimi, referuar jo vetëm dokumentacionit por edhe vlersimeve nga studentët, e zhvillon aktivitetin e tij në plotësim të kërkesave e detyrimeve kontraktuale, në plotësim të nevojave institucionale si dhe duke konsideruar në vazhdimësi sugjerimet për rritjen e cilësisë.
- 9) Bashkëpunimi me organizata/ndërmarrje/institucione i saksionuar në 21 kontrata vetëm për programin e studimit “Art dhe Dizajn” dhe i konkretizuar në zhvillimin e praktikave profesionale në mjediset e tyre, shërben si një urë lidhëse në marrdhëniet teori-praktikë dhe u krijon studentëve ndjesinë që ata po fitojnë profesione që u sigurojnë të ardhme.
- 10) Universiteti Polis në kuadrin e realizimit të synimeve të tij për ndërkombëtarizimin e studimeve është përzgjedhur për të qenë pjesëtar i “Aleancës Universitare Europiane Bauhaus 4EU” çfarë e obligon atë për të arritur cilësi sa më të lartë (europiane) në realizimin e procesit mësimor e kërkimit shkencor në të gjitha PS.



- 11) Bashkëpunimi në kuadrin e një programi doktorat ndërkombëtar me universitetin e Ferrarës në Itali siguron një avantazh të madh në kualifikimin e vazhdueshëm të personelit akademik me gradën Msc, i cili në PS “Art dhe Dizajn” përbën 43% të PAE dhe 55 % të PAE+PAK.
- 12) Politikat instucionale të Universitetit Polis edhe për programin mësimor Bch “Art dhe Dizajn” konsiderojnë arritjet, adresojnë problematikat dhe hartojnë politika që synojnë përmirësimin e mëtijshëm të cilësisë në të gjitha aktivitetet.

Pika të dobta

- 1) Edhe pse ngarkesa mësimore për personelin akademik në institucionet jopublike të arsimit të lartë përcaktohet nga vetë institucioni (Ligji 80/2015 , neni 59 pika 8) GJV, duke shqyrtuar ngarkesën mësimore për personelin akademik të PS Bch “Art dhe Dizajn” vlerëson që kjo ngarkesë (në 61% të rasteve më e madhe se 360 orë për PAE) nuk është në favor të rritjes së cilësisë së procesit mësimor. (Standardi IV.1, kriteret 1).
- 2) Universiteti Polis, për programin mësimor Bch në “Art dhe Dizajn”, është përgaditur për një fluks të kontigjentit hyrës deri në 90-100 studentë, nëse ky fluks bie për shkak edhe të rënjes së numrit të maturanteve në përgjithësi e atyre të shkollave artistike në veçanti atëhere rrezikohet perspektiva e tij, pasi peshën kryesore për financimin e këtij PS e mban zëri “Tarifa për dhe gjatë shkollimit” (90.5%) (Standardi IV.5, kriteri 2)

Rekomandime


- 1) Të zgjidhet problemi i ngarkesës së lartë mësimore (mbi 360 orë) për PAE duke e ulur atë deri në 300-360 orë mësimore, nëpërmjet rekrutimit të PAE sipas kriterëve që duhet të plotësohen për rekrutim,
- 2) Të realizohet një shpërndarje më optimale e ngarkesës mësimore për PAE pasi variacioni i saj në intervalin nga 120 deri 473 orë mësimore nuk favorizon trajtim të barabartë të personelit të angazhuar me këtë PS.
- 3) Të synohet rritja e peshës së financimeve përtej zërit “Tarifa për dhe gjatë shkollimit” në mënyrë që të krijohet një ekuilibër në mbështetjen financiare të PS “Art dhe Dizajn”, me vartësi sa më të vogël nga kontigjenti hyrës.
- 4) Për një vlersim sa më objektiv nga ana e studentëve e cilësisë së mësimdhënjes të personelit akademik, GJV rekomandon që studentët gjatë intervistimit të ndahen në dy grupe, duke konsideruar veçmas studentët cilësorë (psh me notë mesatare mbi 8) dhe veçmas të tjerët. (Standardi VI.1, kriteret 2,3)



**Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Art & Dizajn"
provided by the Higher Education Institution "POLIS UNIVERSITY"**

Strengths and affirmations

- 1) The curriculum of the "Art and Design" Study Program has formed contingents welcomed by the labor market, thus proving its didactic values in both the teaching and learning fields.
- 2) The teaching and professional practice and concretization environments for this SP are ample, well-equipped and functional. They create good opportunities for students to be attentive in their studies and creative in their concretization.
- 3) The relatively high and stable number of incoming contingents (an average of 89 students in the last three years) has had a very positive impact on the dedicated commitment of both the academic teaching staff and the institutional support to this program.
- 4) The consideration of the Accreditation Board's recommendations has also had a positive impact, especially on the improvement of the laboratories and studios, raising them to the level of highly functional environments for the concretization of knowledge.
- 5) Thanks to the level of theoretical knowledge acquisition and their concretization in the university environment, students of this study program are almost all welcomed in the labor market as soon as they finish the second year of Bachelor studies.
- 6) The quality of the incoming contingent (average of the last 6 years 8.2) constitutes a strong impetus for increasing the quality of teaching in this study program.
- 7) The many years of experience in employing contingents of the PS Bch "Art and Design" make it targeted and appreciated by those who want to continue their studies in art and design.
- 8) The effective academic staff, those with contracts and those academic assistants engaged in this study program, referring not only to the documentation but also to the assessments by the students, develops its activity in fulfillment of the contractual requirements and obligations, in fulfillment of the institutional needs, as well as by continuously considering suggestions for increasing quality.
- 9) Cooperation with organizations/enterprises/institutions, stipulated in 21 contracts only for the "Art and Design" study program and concretized in the development of professional practices in their environments, serves as a bridge in theory-practice relationships and creates for students the feeling that they are acquiring professions that provide them with a future.
- 10) Polis University, in the framework of realizing its goals for the internationalization of studies, has been selected to be a member of the "Bauhaus 4EU European University Alliance", which obliges it to achieve the highest possible (European) quality in the implementation of the teaching and scientific research process in all SPs.
- 11) Cooperation within the framework of an international doctoral program with the University of Ferrara in Italy provides a great advantage Design" constitutes 43% of the PAE and 55% of the PAE+PAK.



12) The institutional policies of Polis University also for the Bch "Art and Design" curriculum consider achievements, address issues and draft policies that aim to further improve quality in all activities.

Weaknesses

1) Although the teaching load for academic staff in non-public higher education institutions is determined by the institution itself (Law 80/2015, article 59 point 8), the GVJ, examining the teaching load for academic staff of the PS Bch "Art and Dizajn" assesses that this load (in 61% of cases greater than 360 hours per PAE) is not in favor of increasing the quality of the teaching process. (Standard IV.1, criteria 1).

2) Polis University, for the Bch curriculum in "Art and Design", is prepared for an influx of incoming contingent of up to 90-100 students, if this influx falls due to the decrease in the number of graduates in general and those of art schools in particular, then its perspective is jeopardized, since the main weight for financing this PS is held by the item "Tuition fees for and during education" (90.5%) (Standard IV.5, criterion 2)


Recommendation

To solve the problem of the high teaching load (over 360 hours) for PAE by reducing it to 300-360 teaching hours, through the recruitment of PAE according to the criteria that must be met for recruitment,

2) To achieve a more optimal distribution of the teaching load for PAE since its variation in the interval from 120 to 473 teaching hours does not favor equal treatment of the personnel engaged with this SP.

3) To aim to increase the weight of funding beyond the item "Fees for and during education" in order to create a balance in the financial support of the SP "Art and Design", with as little dependence as possible on the incoming contingent.

4) For a more objective assessment by students of the quality of teaching of academic staff, GVJ recommends that students be divided into two groups during the interview, considering separately qualitative students (e.g. with an average grade above 8) and separately others. (Standard VI.1, criteria



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X